



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS



7 QERSHOR, 2026

DEMOKRACIA NË VEPRIM

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS

7 QERSHOR, 2026

DEMOKRACIA NË VEPRIM

Copyright ©2026. Demokracia në Veprim (DnV).

Opinionet, gjetjet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Demokracia në Veprim

Adresa: Rruga “Bajram Kelmendi” nr. 239
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 248 038
Ueb: www.demokracianeveprim.org

Dizajn: ENVINION

PËRMBAJTJA

LISTA E AKRONIMEVE	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-SË	10
2. KONTEKSTI POLITIK	12
3. KORNIZA LIGJORE	13
4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	15
4.1 Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	15
4.2 Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve	17
4.3 Puna në Qendrat Komunale të Numërimit	17
4.4 Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve	20
4.5 Votimi jashtë vendit	20
4.6 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre	21
4.7 Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve	23
5. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR	34
6. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	38
7. DITA E ZGJEDHJEVE	39
8. REZULTATET ZGJEDHORE	41
9. DREJTËSIA ZGJEDHORE	43
REKOMANDIMET	48
I. Administrimi i zgjedhjeve nga KQZ-ja dhe trupat zgjedhore	48
II. Dita e Zgjedhjeve dhe procedurat në vendvotime	50
III. Numërimi, QKN, QNR dhe publikimi i rezultateve	50
IV. Drejtësia zgjedhore	51
V. Përfaqësimi gjinor	52
Shtojca 1: Rezultatet e certifikuara të zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike	53
Shtojcat 2 dhe 3: Përfaqësimi i grave sipas subjekteve politike	54

LISTA E AKRONIMEVE

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
DnV	Demokracia në Veprim
IRDK	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
JGP	Jedinstvena Goranska Partija
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KDTP	Kosova Demokratik Türk Partisi
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KKZ	Komisioni Komunal Zgjedhor
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
NDS	Nova Demokratska Stranka
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PLE	Partia Liberale Egjiptiane
PREBK	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
PSA	Partia Socialdemokrate e Ashkalinjve
PVT	Numërimi Paralel i Votave / Parallel Vote Tabulation
PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
QKN	Qendra Komunale e Numërimit
QNR	Qendra e Numërimit dhe Rezultateve
SDU	Socijaldemokratska Unija
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
SMS	Shërbimi i Mesazheve të Shkurtra
VAKAT	Koalicija Vakati

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” (DnV) vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan përgjithësisht në përputhje me standardet demokratike për zgjedhje të lira, konkurruese dhe të qeta.

Procesi zgjedhor, përfshirë përgatitjet e KQZ-së për organizimin e zgjedhjeve, përkatësisht dita e votimit, numërimi, trajtimi i votave jashtë Kosovës, shqyrtimi i ankesave dhe shpallja e rezultateve, u administrua në mënyrë përgjithësisht profesionale dhe pa probleme që do të cenonin integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Krahastuar me proceset e fundit zgjedhore, këto zgjedhje shënuan përmirësim të dukshëm në administrimin teknik, publikimin e rezultateve, numërimin në QKN dhe përmbylljen e fazës paszgjedhore.

Zgjedhjet u mbajtën në një kontekst të pazakontë politik dhe institucional, duke përbërë procesin e tretë zgjedhor në nivel vendi brenda një periudhe prej rreth gjashtëmbëdhjetë muajsh. Këto cikle të njëpasnjëshme të zgjedhjeve ishin pasojë e pamundësisë së akterëve politikë për të ndërtuar institucione stabile dhe për të siguruar konsensusin minimal të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit institucional. Në krahasim me proceset e fundit zgjedhore, fushata dhe Dita e Zgjedhjeve shpërfaqën një lodhje zgjedhore, e shprehur në mobilizim më të ulët politik, pjesëmarrje më të kufizuar qytetare në aktivitete publike dhe rënie të daljes në votime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi shumicën dërrmuese të operacioneve zgjedhore në mënyrë profesionale dhe brenda afateve të parapara. Ndryshe nga disa procese të mëhershme zgjedhore, puna e KQZ-së u karakterizua nga më pak përplasje politike dhe nga një proces vendimmarrës më funksional dhe konsensual. Organizimi i votimit brenda dhe jashtë Kosovës, përgatitjet teknike për Ditën e Zgjedhjeve, menaxhimi i fazave paszgjedhore dhe komunikimi publik me votuesit u realizuan përgjithësisht në mënyrë efektive. Megjithatë, në disa raste KQZ ndërmori veprime që tejkalonin bazën ligjore ekzistuese, veçanërisht përmes disa dispozitave të miratuara në Rregulloren për Vëzhguesit e Zgjedhjeve dhe vendimit për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduar, i cili më pas u anulua nga PZAP.

Votimi jashtë Kosovës u zhvillua pa probleme serioze dhe pa debatet politike që kishin karakterizuar procese të mëhershme. Interesimi i diasporës mbeti i lartë, me 132,212 votues të regjistruar jashtë Kosovës dhe me pjesëmarrje prej 82.46% në votimin fizik në përfaqësitë diplomatike. Administrimi i regjistrimit, votimit fizik, pranimit dhe vlerësimit të pakove postare, si dhe numërimit në QNR, ishte përgjithësisht i rregullt. Megjithatë, publikimi në rrjete sociale i fotografive dhe videove që shfaqnin fletëvotime të plotësuar vazhdon të krijojë shqetësim lidhur me fshehtësinë e votës dhe integritetin e votimit jashtë Kosovës.

Fushata zgjedhore u zhvillua në një ambient konkurrues dhe përgjithësisht të qetë. Subjektet politike patën mundësi të zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe të komunikojnë lirshëm me votuesit në të gjithë territorin e vendit. Diskursi politik ishte më i moderuar krahasuar me disa procese të mëhershme zgjedhore dhe nuk u shoqërua me incidente serioze. Megjithatë, cenimi i barazisë së garës mbeti një nga çështjet kryesore të evidentuara gjatë kësaj periudhe. Vendimet e Qeverisë në detyrë për ndarjen e pagesave të njëhershme financiare për kategori të ndryshme të qytetarëve dhe subvencionimin e linjave ajrore për mërgatën në prag të zgjedhjeve cenuan barazinë e garës ndërmjet konkurrentëve politikë.

Mediat luajtën rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve gjatë periudhës zgjedhore dhe ofruan hapësirë për prezantimin e qëndrimeve të subjekteve politike. Megjithatë, raportimi dhe debatet publike shpesh u fokusuan më shumë në dinamikat e garës dhe retorikën politike sesa në analizimin e programeve dhe politikave konkrete të propozuara nga garuesit. Një mangësi e dukshme ishte mungesa e përballjeve të drejtpërdrejta ndërmjet kandidatëve për kryeministër, gjë që kufizoi mundësinë e qytetarëve për të krahasuar alternativat politike përmes debatit të drejtpërdrejtë.

Fushata zgjedhore vazhdoi të zhvendoset në masë të konsiderueshme në hapësirën digjitale, ku rrjetet sociale shërbyen si një nga kanalet kryesore të komunikimit politik. DnV monitoroi rreth 500 profile në rrjete sociale, përfshirë profilet zyrtare të partive kryesore, kandidatët e tyre dhe kandidatë të subjekteve nga komuniteti serb. Vetëm



Votimi jashtë Kosovës u zhvillua pa probleme serioze dhe pa debatet politike që kishin karakterizuar procese të mëhershme.

gjatë fushatës zyrtare zgjedhore 10 ditëshe u evidentuan shpenzime për sponsorizim në platformat Meta në vlerë prej mbi 100 mijë eurosh.

Oferta politike u fokusua kryesisht në çështje ekonomike dhe sociale, ndërsa debati publik shpesh dominohej nga mesazhe politike dhe slogane elektorale më shumë sesa nga diskutime të detajuara mbi politikat publike, koston financiare të premtimeve dhe burimet e financimit. Fushata mbeti kryesisht e përqendruar rreth liderëve partiakë, ndërsa gratë vazhduan të jenë më pak të përfaqësuara në debate publike dhe hapësirë mediatike sesa në listat zgjedhore. Kjo tregon se përfshirja formale e grave në lista nuk është e mjaftueshme për pjesëmarrje të barabartë në garën politike.

Dita e Zgjedhjeve u zhvillua në atmosferë të qetë dhe pa incidente serioze që do të mund të cenonin integritetin e procesit. Hapja, votimi dhe mbyllja e vendvotimeve u administruan përgjithësisht në mënyrë të rregullt. Meg-

Interesimi i diasporës mbeti i lartë, me 132,212 votues të regjistruar jashtë Kosovës

jithatë, një nga problemet më të shprehura gjatë ditës mbeti vështirësia e votuesve për të gjetur vendvotimin e saktë, fenomen i evidentuar në një numër të konsiderueshëm vendvotimesh. Po ashtu, sfidë vazhdon të mbetet qasja e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit, si dhe zbatimi jo gjithmonë i njëtrajtshëm i disa procedurave zgjedhore.

Një zhvillim veçanërisht pozitiv i këtyre zgjedhjeve ishte rënia e ndjeshme e votimit me asistencë. Të dhënat e DnV-së tregojnë se zbatimi më i rreptë i rregullave për këtë formë votimi ka ndikuar dukshëm në uljen e rasteve të evidentuara krahasuar me proceset e mëparshme zgjedhore, duke kontribuar në mbrojtjen e integritetit të votës.

Procesi i numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit shënoi përmirësim të dukshëm krahasuar me proceset paraprake. QKN-të funksionuan në mënyrë më të rregullt dhe transparente, sa i përket verifikimit të votave të subjekteve politike dhe numërimit të votave të kandidatëve.

me pjesëmarrje pre 82.46% në votimin fizik në përfaqësitë diplomatike.


Përdorimi i kamerave dhe monitorëve, qasja e vëzhguesve dhe organizimi më i mirë i procesit kontribuan në rritjen e besueshmërisë së kësaj faze. Problemet e evidentuara ishin kryesisht teknike ose njerëzore dhe të përqendruara në tavolina apo vendvotime të caktuara.

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve i administroi pa vonesa procedurat që lidhen me votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta, votat jashtë Kosovës dhe rinumërimet. Rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta, apo 7.41% të vendvotimeve, tregoi ndryshime shumë të kufizuara në votat e subjekteve politike, derisa ndryshimet në votat e kandidatëve, ndonëse ishin më të shumta në numër, ishin megjithatë të vogla sa i përket ndikimit dhe të lidhura kryesisht me natyrën më komplekse të votës preferenciale. Këto të dhëna e mbështesin vlerësimin se gabimet e evidentuara nuk kishin peshë në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

KQZ-ja gjithashtu shënoi përmirësim të dukshëm në komunikimin me publikun. Fushatat digjitale për informimin dhe edukimin e votuesve ishin më të qarta dhe më të pranishme, ndërsa njoftimet për afatet, mënyrën e votimit dhe verifikimin e qendrës së votimit u publikuan në mënyrë më të rregullt. Po ashtu, uebfaqja e KQZ-së dhe platforma për rezultate funksionuan shumë mirë, sidomos në publikimin e të dhënave në kohë reale, duke rritur transparencën dhe qasjen e publikut në informacion.

Mekanizmat e drejtësisë zgjedhore funksionuan në mënyrë efektive gjatë tërë procesit. PZAP dhe Gjykata Supreme trajtuan ankesat dhe kontestet zgjedhore në afatet e parapara ligjore dhe demonstuan nivel të lartë profesionalizmi dhe konsistence në vendimmarrje. Krahastyre, Prokuroria dhe Policia e Kosovës luajtën rol aktiv në trajtimin e rasteve të dyshuara për shkelje të të drejtave zgjedhore dhe në ruajtjen e integritetit të procesit.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan në një ambient demokratik, konkurrues dhe të qetë. Administrimi i procesit zgjedhor ishte përgjithësisht profesional, ndërsa institucionet përgjegjëse arritën të menaxhojnë me sukses shumicën e sfidave organizative dhe procedurale. Megjithatë, përdorimi i masave me ndikim elektorale nga institucionet publike, vështirësitë e vazhdueshme në orientimin e votuesve, pengesat në qasjen për personat me aftësi të kufizuara dhe disa mangësi në zbatimin e procedurave zgjedhore mbeten çështje që kërkojnë adresim në proceset e ardhshme zgjedhore.




Qendra e Numërimit dhe Rezultateve i administroi pa vonesa procedurat që lidhen me votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta, votat jashtë Kosovës dhe rinumërimet.

Rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta, apo 7.41% të vendvotimeve, tregoi ndryshime shumë të kufizuara në votat e subjekteve politike, derisa ndryshimet në votat e kandidatëve, ndonëse ishin më të shumta në numër, ishin megjithatë të vogla sa i përket ndikimit dhe të lidhura kryesisht me natyrën më komplekse të votës preferenciale. Këto të dhëna e mbështesin vlerësimin se gabimet e evidentuara nuk kishin peshë në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve.

1. MISIONI DHE METODOLOGJIA E DNV-së

Demokracia në Veprim (DnV) është koalicion i organizatave vendore të shoqërisë civile në Kosovë, i angazhuar për promovimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe demokratike përmes vëzhgimit sistematik të proceseve zgjedhore, raportimit publik, edukimit të votuesve dhe avokimit për reforma zgjedhore. Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026, DnV ka angazhuar rreth 750 vullnetarë dhe anëtarë të ekipeve profesionale për të siguruar vëzhgim të pavarur, të paanshëm dhe gjithëpërfshirës të procesit zgjedhor.

Ky raport paraqet vlerësimin e DnV-së për procesin zgjedhor në tërësi, duke përfshirë periudhën që nga shpallja e datës së zgjedhjeve, punën e institucioneve përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, fushatën zgjedhore, votimin jashtë Kosovës, Ditën e Zgjedhjeve, numërimin në Qendrat Komunale të Numërimit, procedurat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, shqyrtimin e ankesave dhe kontesteve zgjedhore, si dhe fazën e shpalljes dhe certifikimit të rezultateve.



Në Ditën e Zgjedhjeve, DnV ka angazhuar mbi

600

vullnetarë në terren.

Prej tyre, 500 vëzhgues janë vendosur në 500 vendvotime të përzgjedhura sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave (PVT), bazuar në një mostër përfaqësuese.

Gjatë periudhës përgatitore, DnV ka monitoruar mbledhjet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimmarrjen e institucioneve zgjedhore, zbatimin e planit operacional dhe kalendarit të aktiviteteve zgjedhore të KQZ-së, procesin e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve, përgatitjet për votimin brenda dhe jashtë Kosovës, si dhe çështjet që lidhen me listën e votuesve.

DnV ka monitoruar gjithashtu fushatën zgjedhore, përfshirë aktivitetet publike të subjekteve politike, komunikimin politik në terren, përdorimin e resurseve publike, përfaqësimin e grave dhe grupeve të tjera në fushatë, rolin e mediave dhe zhvillimet në hapësirën digjitale. Monitorimi i fushatës është mbështetur në raportime nga terreni, përcjellje të aktiviteteve publike, analizë të komunikimit online dhe shqyrtim të të dhënave të disponueshme mbi shpenzimet për promovim të sponsorizuar në rrjete sociale.

Në Ditën e Zgjedhjeve, DnV ka angazhuar mbi 600 vullnetarë në terren. Prej tyre, 500 vëzhgues janë vendosur në 500 vendvotime të përzgjedhura sipas metodologjisë së Numërimit Paralel të Votave (PVT), bazuar në një mostër përfaqësuese. Kjo metodologji ka mundësuar mbledhjen e të dhënave të besueshme statistikore mbi hapjen e vendvotimeve, pjesëmarrjen në votime, zhvillimin e procesit të votimit, respektimin e procedurave dhe rezultatet preliminare për subjektet politike.

Përveç vëzhguesve të vendosur në vendvotime sipas mostrës PVT, DnV ka angazhuar edhe rreth 50 vëzhgues në ekipe mobile, të cilët kanë përcjellë atmosferën e përgjithshme në Qendrat e Votimit dhe përreth tyre, qasjen e votuesve, praninë e materialeve promovuese, sigurinë dhe çështje të tjera që nuk mund të mbulohen plotësisht përmes vëzhgimit në vendvotime të veçanta. Rreth 50 vullnetarë të tjerë janë angazhuar në Qendër të Thirrjeve/ Dhënave, ku janë pranuar, verifikuar, procesuar dhe analizuar raportimet nga terreni gjatë gjithë ditës.

Pas përfundimit të votimit, DnV ka vazhduar vëzhgimin e procesit të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit përmes rreth 100 vëzhguesve në terren – përkatësisht me minimalisht dy vëzhgues për secilën qendër komunale të numërimit, derisa në komunat e mëdha janë angazhuar deri në katër vëzhgues. Ky vëzhgim ka përfshirë pranimin e materialit zgjedhor, verifikimin e votave për subjekte politike, numërimin e votave për kandidatët, respektimin e procedurave, transparencën e procesit dhe qasjen e vëzhguesve. Po ashtu, DnV ka përcjellë edhe punën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, përfshirë trajtimin e votave me kusht, votave nga jashtë Kosovës, votave të personave me nevojë të veçanta dhe procedurat eventuale të rinumërimit.

Ekipet ligjore të DnV-së kanë përcjellë në vazhdimësi procesin e shqyrtimit të ankesave dhe parashtresave në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, si dhe vendimmarrjen e Gjykatës Supreme për çështjet zgjedhore. DnV ka monitoruar gjithashtu angazhimin e institucioneve të rendit dhe drejtësisë në trajtimin e rasteve të dyshuara për vepra penale kundër të drejtave zgjedhore.

Të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit e DnV-së janë raportuar përmes platformave të brendshme të raportimit, janë verifikuar nga ekipet përgjegjëse dhe janë analizuar nga stafi profesional dhe ekspertët e an-

Pas përfundimit të votimit, DnV ka vazhduar vëzhgimin e procesit të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit përmes rreth 100 vëzhguesve në terren – përkatësisht me minimalisht dy vëzhgues për secilën qendër komunale të numërimit, derisa në komunat e mëdha janë angazhuar deri në katër vëzhgues. Ky vëzhgim ka përfshirë pranimin e materialit zgjedhor, verifikimin e votave për subjekte politike, numërimin e votave për kandidatët, respektimin e procedurave, transparencën e procesit dhe qasjen e vëzhguesve. Po ashtu, DnV ka përcjellë edhe punën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, përfshirë trajtimin e votave me kusht, votave nga jashtë Kosovës, votave të personave me nevojë të veçanta dhe procedurat eventuale të rinumërimit.

gazhuar për këtë proces. Gjatë Ditës së Zgjedhjeve, DnV ka informuar publikun përmes konferencave të rregullta për media dhe komunikimit në rrjete sociale, ndërsa pas përfundimit të fazave kryesore të procesit ka përgatitur vlerësimin përfundimtar të paraqitur në këtë raport.

Metodologjia e vëzhgimit të DnV-së është ndërtuar mbi parimet e paanshmërisë, objektivitetit, transparencës dhe respektimit të standardeve ndërkombëtare për vëzhgim vendor të zgjedhjeve. Gjetjet dhe rekomandimet në këtë raport bazohen në të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi në terren, monitorimi institucional, analiza ligjore dhe shqyrtimi i dokumenteve dhe vendimeve publike të institucioneve përgjegjëse për administrimin dhe mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor.

2. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u mbajtën në një kontekst të pazakontë politik dhe institucional, duke shënuar procesin e tretë zgjedhor në nivel vendi brenda një periudhe prej rreth gjashtëmbëdhjetë muajsh. Kjo dinamikë e shpeshtë zgjedhore ishte pasojë e vështirësive të vazhdueshme të akterëve politikë për të ndërtuar institucione stabile dhe për të siguruar nivelin minimal të konsensusit të nevojshëm për funksionimin normal të sistemit parlamentar.

Blokada pas zgjedhjeve të shkurtit 2025 ndikoi drejtpërdrejt në funksionimin e institucioneve. Pamundësia për konstituimin e plotë të Kuvendit, zgjedhjen e organeve të tij dhe formimin e Qeverisë prodhoi pasiguri institucionale dhe e kufizoi aftësinë e vendit për të marrë vendime të rregullta politike, ligjore dhe buxhetore. Në këtë periudhë, debati publik u dominua nga çështje të procedurave parlamentare, interpretimeve kushtetuese dhe përgjegjësisë politike për bllokadën, duke e thelluar edhe më tej polarizimin ndërmjet subjekteve politike.

Në mungesë të kompromisit politik, Gjykata Kushtetuese u përfshi në mënyrë të përsëritur në sqarimin e çështjeve që lidhen me konstituimin e institucioneve, procedurat parlamentare dhe zbatimin e afateve kushtetuese. Roli i Gjykatës ishte i domosdoshëm për të qartësuar rrugëdaljet institucionale, por njëkohësisht tregoi se akterët politikë nuk po arrinin të zgjidhnin mosmarrëveshjet përmes dialogut politik. Kjo e zhvendosi një pjesë të rëndësishme të krizës nga arena parlamentare në atë kushtetuese dhe juridike.

Zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit 2025 u panë si mundësi për tejkalimin e ngërçit institucional. Ato mundësuan konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e Qeverisë, por nuk prodhuan stabilitet të qëndrueshëm politik. Raportet ndërmjet forcave parlamentare mbetën të brishta, ndërsa mungesa e gatishmërisë për bashkëpunim politik vazhdoi të kufizojë funksionalitetin e institucioneve. Në këtë kuptim, zgjedhjet e dhjetorit ofruan zgjidhje të përkohshme për krijimin e institucioneve, por jo edhe zgjidhje për krizën më të gjerë të besimit dhe bashkëpunimit politik.

Kriza kulmoi me dështimin e Kuvendit për të zgjedhur Presidentin e Republikës brenda afateve kushtetuese, duke çuar në shpërndarjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedh-

jeve të reja parlamentare. Për pasojë, zgjedhjet e 7 qershorit 2026 u panë si vazhdim i një krize të gjatë institucionale që ende nuk kishte gjetur zgjidhje të qëndrueshme.

Kjo rrethanë në veçanti, por edhe i tërë konteksti politik dhe i përsëritur zgjedhor, ndikuan ndjeshëm në atmosferën zgjedhore. Krahasuar me proceset e mëparshme, fushata për zgjedhjet e 7 qershorit u zhvillua me nivel më të ulët mobilizimi politik dhe qytetar. Aktivitetet publike ishin më pak intensive, pjesëmarrja qytetare ishte më e kufizuar dhe interesimi publik për procesin ishte më i dobët. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e elektoratit e përjetoi procesin më shumë si vazhdimësi të krizës së mëparshme sesa si fillim të një cikli të ri politik.

Rënia e pjesëmarrjes në votime e konfirmoi këtë prirje. Sipas të dhënave, dalja në votime më 7 qershor ishte prej më të ulëtave në historinë e zgjedhjeve parlamentare pas shpalljes së pavarësisë. Ajo ishte dukshëm më e ulët krahasuar me zgjedhjet parlamentare të mbajtura vetëm gjashtë muaj më parë, si dhe me zgjedhjet e shkurtit 2025. Ky zhvillim përbën një nga treguesit më të qartë të lodhjes zgjedhore dhe të rënies së motivimit qytetar për të marrë pjesë në procese të përsëritura zgjedhore që nuk kishin prodhuar stabilitet institucional.

Në të njëjtën kohë, zgjedhjet u zhvilluan në një ambient ku integriteti i administrimit zgjedhor dhe besueshmëria e fazave paszgjedhore mbetën pjesë e rëndësishme e debatit publik. Proceset e mëparshme ishin shoqëruar me vonesa në numërim dhe certifikim, probleme gjatë numërimit të votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit, konteste lidhur me votimin jashtë Kosovës dhe hetime për dyshime për shkelje zgjedhore. Këto zhvillime e rritën ndjeshmërinë publike ndaj mënyrës se si administrohen zgjedhjet, si numërohen votat dhe si trajtohen kontestet zgjedhore.

Në përgjithësi, konteksti politik i këtyre zgjedhjeve u përcaktua nga tri elemente kryesore, përfshirë paqëndrueshmërinë institucionale, mungesën e kompromisit politik dhe lodhjen qytetare nga zgjedhjet e përsëritura. Këto elemente ndikuan drejtpërdrejt në natyrën e fushatës, nivelin e pjesëmarrjes dhe pritjet publike ndaj procesit.

3. KORNIZA LIGJORE


Korniza ligjore për zgjedhjet parlamentare në Kosovë përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kodi Penal, si dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Kjo kornizë rregullon të gjitha fazat kryesore të procesit zgjedhor, përfshirë shpalljen e zgjedhjeve, administrimin e tyre, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, votimin brenda dhe jashtë Kosovës, numërimin e votave, shqyrtimin e ankesave dhe certifikimin e rezultateve.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvilluan mbi të njëjtën kornizë ligjore primare që ishte zbatuar edhe në proceset e fundit zgjedhore. Nuk pati ndryshime në legjislacionin primar zgjedhor ndërmjet zgjedhjeve të dhjetorit 2025 dhe zgjedhjeve të qershorit 2026. Për rrjedhojë, sistemi zgjedhor, mënyra e ndarjes së mandateve, rregullat për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë, kuota gjinore, procedurat kryesore të votimit dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtës së votës mbetën të pandryshuara.

Kosova vazhdon të zbatojë sistem proporcional me lista të hapura, ku i gjithë territori i vendit përbën një zonë të vetme zgjedhore. Kuvendi i Kosovës ka 120 ulëse, prej të cilave 20 janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë, respektivisht 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet tjera jo-shumicë. Për subjektet politike që garojnë për ulëset jo të garantuara aplikohet pragu zgjedhor prej 5%, ndërsa ky prag nuk zbatohet për subjektet që garojnë për ulëset e garantuara. Votuesit kanë të drejtë të votojnë për një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë brenda listës së atij subjekti.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar në vitin 2023, kishte sjellë disa ndryshime të rëndësishme në administrimin e zgjedhjeve, përfshirë zgjerimin e formave të votimit jashtë Kosovës, numërimin e votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit dhe zgjerimin e votës preferenciale deri në dhjetë kandidatë. Këto ndryshime vazhduan të zbatohen edhe në zgjedhjet e 7 qershorit 2026. Përvoja e proceseve të fundit zgjedhore ka treguar se disa prej këtyre ndryshimeve kanë përmirësuar mundësitë e pjesëmarrjes, sidomos për votuesit jashtë Kosovës, por njëkohësisht kanë rritur kompleksitetin ad-

Kosova vazhdon të zbatojë sistem proporcional me lista të hapura, ku i gjithë territori i vendit përbën një zonë të vetme zgjedhore. Kuvendi i Kosovës ka **120 ulëse**, prej të cilave **20 janë të garantuara për komunitetet jo-shumicë, respektivisht 10 për komunitetin serb dhe 10 për komunitetet tjera jo-shumicë**. Për subjektet politike që garojnë për ulëset jo të garantuara aplikohet pragu zgjedhor prej 5%, ndërsa ky prag nuk zbatohet për subjektet që garojnë për ulëset e garantuara. Votuesit kanë të drejtë të votojnë për një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë brenda listës së atij subjekti.



ministrativ të procesit dhe kërkesat për kapacitete më të mëdha organizative nga institucionet zgjedhore.

Gjatë periudhës para zgjedhjeve të 7 qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miratoi ndryshime dhe plotësime në katër rregullore zgjedhore. Këto ndryshime kishin të bënin me regjistrimin dhe votimin jashtë Kosovës, funksionimin e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve, procedurat e votimit, numërimit në vendvotim dhe menaxhimit të vendvotimit, si dhe rregullimin e procedurave të akreditimit të vëzhguesve të zgjedhjeve. Shumica e këtyre ndryshimeve kishin karakter teknik dhe synonin përshtatjen e procedurave me përvojat e proceseve të fundit zgjedhore.

Ndryshimi më problematik lidhej me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2026 për Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Përmes kësaj rregulloreje, KQZ zgjeroi kuadrin e dokumentacionit dhe informacionit që kërkohet nga organizatat e shoqërisë civile për akreditim, duke vendosur kërkesa që shkojnë përtej atyre të përcaktuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo qasje e cenoj mundësinë e ushtrimit të vëzhgimit të pavarur të zgjedhjeve, duke e rënduar procesin e akreditimit dhe duke i dhënë KQZ-së hapësirë më të gjerë vlerësimi në një fushë ku ligji parasheh kritere të qarta dhe të kufizuara.

DnV vlerëson se rregullimi i vëzhgimit të zgjedhjeve duhet të mbetet i lidhur ngushtë me bazën ligjore. Vëzhgimi i zgjedhjeve është mekanizëm i rëndësishëm për transparencën dhe besueshmërinë e procesit zgjedhor, prandaj procedurat e akreditimit duhet ta lehtësojnë ushtrimin e këtij roli, jo ta rëndojnë atë me kërkesa administrative që nuk janë të domosdoshme për integritetin e procesit.

Një rast tjetër që dëshmoi nevojën për kujdes më të madh në interpretimin e kompetencave të KQZ-së ishte vendimi për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduara. Ky vendim u anulua nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa pas ankesës së KDI-së. Vendimmarrja e PZAP-së riktheu zbatimin e standardit ligjor për identifikimin e votuesve dhe konfirmoi rëndësinë e kontrollit juridik mbi vendimet e administratës zgjedhore.

Përveç çështjeve që lidhen me aktet nënligjore, procesi i 7 qershorit tregoi edhe vazhdimësinë e ekzistimit të disa zbrazëtirave në legjislacionin zgjedhor. Aktivitetet politike para fillimit zyrtar të fushatës mbeten të parregulluara, duke u lënë subjekteve politike dhe kandidatëve hapësirë për promovim paraelektoral pa të njëjtin nivel transparence, llogaridhënie dhe raportimi financiar që kërkohet gjatë fushatës zyrtare.

Edhe fushata në hapësirën digjitale vazhdon të zhvillohet më shpejt sesa kapaciteti rregullues i institucioneve. Reklamimi i sponsorizuar në rrjete sociale, përdorimi i faqeve jozyrtare, prodhimi i përmbajtjeve të kushtueshme digjitale dhe shpërndarja e dezinformative kërkojnë rregulla më të qarta për transparencën e shpenzimeve, identifikimin e porositesve të përmbajtjes politike dhe raportimin financiar të aktiviteteve online.

Standardi i përshtatshmërisë ligjore të kandidatëve mbetet po ashtu çështje që kërkon rishikim. Pas ndry-

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, i miratuar në vitin 2023, kishte sjellë disa ndryshime të rëndësishme në administrimin e zgjedhjeve, përfshirë zgjerimin e formave të votimit jashtë Kosovës, numërimin e votave të kandidatëve në Qendrat Komunale të Numërimit dhe zgjerimin e votës preferenciale deri në dhjetë kandidatë. Këto ndryshime vazhduan të zbatohen edhe në zgjedhjet e 7 qershorit 2026. Përvoja e proceseve të fundit zgjedhore ka treguar se disa prej këtyre ndryshimeve kanë përmirësuar mundësitë e pjesëmarrjes, sidomos për votuesit jashtë Kosovës, por njëkohësisht kanë rritur kompleksitetin administrativ të procesit dhe kërkesat për kapacitete më të mëdha organizative nga institucionet zgjedhore.

shimeve ligjore të vitit 2023, ndalesa për kandidim lidhet kryesisht me dënimet me burgim efektiv mbi një vit. Ky standard lë hapësirë që persona të dënuar për vepra që lidhen me korrupsionin ose keqpërdorimin e detyrës publike të mbeten të pranueshëm për kandidim në rastet kur ndaj tyre janë shqiptuar dënime alternative ose gjoba.

Në aspektin e barazisë gjinore, korniza ligjore vazhdon të garantojë përfaqësim minimal prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar në listat zgjedhore dhe në ndarjen e ulëseve. Megjithatë, përvoja e këtyre zgjedhjeve tregon se kuota ligjore vazhdon të sigurojë kryesisht përfaqësim formal, ndërsa pjesëmarrja substanciale e grave në fushatë, në debatet publike dhe në vendimmarrjen politike mbetet e kufizuar.

Në përgjithësi, korniza ligjore mundësoi organizimin e zgjedhjeve të 7 qershorit 2026 dhe ofroi bazë të mjaftueshme për administrimin e procesit. Megjithatë, përvoja e këtij procesi, por edhe të tjerëve të zhvilluar gjatë viteve të fundit, konfirmojnë nevojën për rishikim të legjislacionit zgjedhor, për të adresuar mangësitë kryesore teknike, por edhe ato përmbajtësore të sistemit zgjedhor të Kosovës.

4. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore në fuqi, organi përgjegjës për përgatitjen, mbikëqyrjen, drejtimin dhe verifikimin e veprimeve që lidhen me procesin zgjedhor, si dhe për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, KQZ-ja mbështetet nga Sekretariati i KQZ-së, i cili mban barrën kryesore të zbatimit teknik dhe administrativ të operacioneve zgjedhore.

Në nivel komunal, administrimi i zgjedhjeve realizohet përmes Komisioneve Komunale Zgjedhore, të cilat funksionojnë në secilën prej 38 komunave të Kosovës. Këto komisione janë përgjegjëse për përgatitjet teknike në nivel lokal, koordinimin me KQZ-në, shërbimin ndaj votuesve, organizimin e trajnimeve dhe mbështetjen e trupave që administrojnë votimin në ditën e zgjedhjeve.

Procesi i votimit në vendvotime administrohet nga Këshillat e Vendvotimeve, të cilat përbëhen nga anëtarë të nominuar nga subjektet politike dhe të emëruar sipas procedurave të përcaktuara nga KQZ-ja. Pas përfundimit të votimit, procesi vazhdon në Qendrat Komunale të Numërimit, ku bëhet pranimi i materialit zgjedhor, verifikimi i votave për subjekte politike dhe numërimi i votave për kandidatët. Qendra e Numërimit dhe Rezultateve administron votat me kusht, votat jashtë Kosovës, votat e personave me nevoja të veçanta, rinumërimet eventuale dhe përgatitjen teknike të rezultateve përfundimtare.

Në zgjedhjet e 7 qershorit 2026, administrimi i përgjithshëm i procesit zgjedhor ishte dukshëm më i qetë dhe më i rregullt sesa në proceset paraprake. KQZ-ja dhe Sekretariati i saj arritën të realizojnë operacionet zgjedhore brenda afateve të parapara, pa probleme që do të ndikonin drejtpërdrejt në integritetin e përgjithshëm të procesit. Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2025, fazat kryesore të administrimit nuk u shoqëruan me vonesa të mëdha, dështime teknike me pasoja publike apo kontestime të vazhdueshme politike brenda KQZ-së.



Në zgjedhjet e 7 qershorit 2026, administrimi i përgjithshëm i procesit zgjedhor ishte dukshëm më i qetë dhe më i rregullt sesa në proceset paraprake. KQZ-ja dhe Sekretariati i saj arritën të realizojnë operacionet zgjedhore brenda afateve të parapara, pa probleme që do të ndikonin drejtpërdrejt në integritetin e përgjithshëm të procesit. Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2025, fazat kryesore të administrimit nuk u shoqëruan me vonesa të mëdha, dështime teknike me pasoja publike apo kontestime të vazhdueshme politike brenda KQZ-së.

4.1 Puna e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 në mënyrë përgjithësisht profesionale dhe efikase. Përkundër afateve më të shkurtra për organizimin e procesit, shumica e operacioneve kryesore u realizuan me kohë dhe pa pengesa të mëdha. KQZ-ja miratoi vendimet e nevojshme për organizimin e zgjedhjeve, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, listën e votuesve, votimin jashtë Kosovës, përbërjen e trupave zgjedhore, materialet zgjedhore, si dhe procedurat që lidhen me ditën e votimit dhe fazat pasuese të numërimit.

Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2025, puna e KQZ-së nuk u karakterizua nga tensione të vazhdueshme politike, vonesa të mëdha në operacionet kryesore apo dështime teknike me ndikim të drejtpërdrejtë në besimin publik. Shumica e vendimeve të nevojshme për organizimin e procesit u morën në kohë dhe pa kontestime të mëdha ndërmjet anëtarëve të Komisionit.

Që nga shpallja e zgjedhjeve, KQZ-ja zhvilloi mbledhje më të shpeshta ku u miratuan vendimet kryesore për zbatimin e planit operacion zgjedhor. Këto vendime përfshinë certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, listën e votuesve, votimin jashtë Kosovës, përbërjen e trupave zgjedhore, materialet zgjedhore, procedurat e ditës së votimit dhe fazat pasuese të numërimit. Në shumicën e rasteve, vendimmarrja ishte më e qetë dhe më pak e politizuar sesa në proceset paraprake. Në raste dukshëm më të shpeshta se në ciklet e mëparshme zgjedhor, KQZ-ja përdori edhe procedura të vendimmarrjes përmes mbledhje qarkulluese (pa pjesëmarrje fizike). Ndonëse kjo praktikë mund të jetë e nevojshme për çështje teknike dhe urgjente, përdorimi i saj duhet të mbetet i kufizuar dhe i arsyetuar. Vendimmarrja e KQZ-së, sidomos për çështje me interes publik, duhet të zhvillohet në mënyrë sa më të hapur, me mundësi përcjelljeje nga publiku, mediat dhe vëzhguesit.


Që nga shpallja e zgjedhjeve, KQZ-ja zhvilloi mbledhje më të shpeshta ku u miratuan vendimet kryesore për zbatimin e planit operacion zgjedhor. Këto vendime përfshinë certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, listën e votuesve, votimin jashtë Kosovës, përbërjen e trupave zgjedhore, materialet zgjedhore, procedurat e ditës së votimit dhe fazat pasuese të numërimit. Në shumicën e rasteve, vendimmarrja ishte më e qetë dhe më pak e politizuar sesa në proceset paraprake. Në raste dukshëm më të shpeshta se në ciklet e mëparshme zgjedhor, KQZ-ja përdori edhe procedura të vendimmarrjes përmes mbledhje qarkulluese (pa pjesëmarrje fizike).

Përtej vendimmarrjes përgjithësisht të rregullt, funksionale dhe pa përplasje të theksuara brenda KQZ-së, puna e Sekretariatit të KQZ-së përbën një nga aspektet më pozitive të këtij procesi zgjedhor. Përgatitja e materialeve zgjedhore, koordinimi me strukturat komunale, organizimi i votimit jashtë Kosovës, mbështetja teknike për QKN-të dhe QNR-në, si dhe përpunimi i të dhënave u realizuan me nivel më të lartë rregullsie dhe koordinimi. Kjo pati ndikim të drejtpërdrejtë në mbarëvajtjen e procesit dhe në shmangien e problemeve që kishin karakterizuar zgjedhjet paraprake.

Vlerësim të veçantë meriton edhe puna e Sekretariatit të KQZ-së, që mbajti përgjegjësinë kryesore për zbatimin praktik të operacioneve zgjedhore. Përgatitja e materialeve zgjedhore, organizimi i votimit brenda dhe jashtë Kosovës, koordinimi me strukturat komunale, funksionimi i sistemeve të raportimit dhe përpunimi i të dhënave u realizuan në mënyrë më të rregullt se në proceset paraprake. Kjo u reflektua edhe në ecurinë më të mirë të publikimit të rezultateve dhe në menaxhimin më të mirë të informacionit lidhur me mbarëvajtjen e operacioneve apo procedurave zgjedhore.

Një prej elementeve pozitive në këtë drejtim ishte niveli i transparencës së KQZ-së për ecurinë e aktiviteteve dhe operacioneve zgjedhore.

Në veçanti, vlen të theksohet informimi i vazhdueshëm dhe i paanshëm i publikut nga KQZ për ecurinë e aktiviteteve zgjedhore.



KQZ publikoi njoftime të shpeshta, të rregullta dhe të detajuara gjatë periudhës përgatitore të zgjedhjeve, ditës së votimit dhe fazës paszgjedhore, përmes së cilave, publiku dhe mediat u njoftuan për operacionet zgjedhore brenda dhe jashtë vendit, si dhe për mbarëvajtjen e përditshme të aktiviteteve të numërimit në QKN dhe QNR. Ky informim kishte karakter operacional dhe shpjegues, duke i dhënë publikut dhe mediave të dhëna të rregullta për çdo fazë të procesit zgjedhor.

Një prej elementeve pozitive në këtë drejtim ishte niveli i transparencës së KQZ-së për ecurinë e aktiviteteve dhe operacioneve zgjedhore. Në veçanti, vlen të theksohet informimi i vazhdueshëm dhe i paanshëm i publikut nga KQZ për ecurinë e aktiviteteve zgjedhore. KQZ publikoi njoftime të shpeshta, të rregullta dhe të detajuara gjatë periudhës përgatitore të zgjedhjeve, ditës së votimit dhe fazës paszgjedhore, përmes së cilave, publiku dhe mediat u njoftuan për operacionet zgjedhore brenda dhe jashtë vendit, si dhe për mbarëvajtjen e përditshme të aktiviteteve të numërimit në QKN dhe QNR. Ky informim kishte karakter operacional dhe shpjegues, duke i dhënë publikut dhe mediave të dhëna të rregullta për çdo fazë të procesit zgjedhor.

Performancë të mirë treguan edhe ekipet tjera në SKQZ, përfshirë njësitë përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave, sistemet digjitale, publikimin e rezultateve dhe punës në QNR. Publikimi më i qëndrueshëm, sistematik dhe i detajuar i të dhënave dhe funksionimi më i mirë i platformave online ndikuan pozitivisht në transparencën e procesit dhe në qasjen e qytetarëve, shoqërisë civile, mediave dhe subjekteve politike në informacion.

Pavarësisht vlerësimit përgjithësisht pozitiv, disa vendime të KQZ-së mbetën problematike. Rregullorja për Vëzhguesit e Zgjedhjeve¹ zgjeroi kërkesat për akreditimin e organizatave vëzhguese përtej asaj që parasheh Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme. DnV vlerëson se ky rregullim e cenoi pa nevojë procesin e akreditimit, duke e rënduar atë për organizatat vëzhguese, si dhe i dha KQZ-së hapësirë më të gjerë vlerësimi sesa që përcaktohet në ligj.

1 Rregullore Zgjedhore nr. 04/2026 Vëzhguesit e Zgjedhjeve. Qasur më 08.07.2026 në linkun: <https://kqz-ks.org/wp-content/uploads/2026/05/Rregullore-Zgjedhore-Nr.04-2026-Vezhguesit-e-Zgjedhjeve.pdf>

Vendimi për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduar ishte një tjetër rast ku KQZ-ja tejkaloj bazën ligjore. Ky vendim u anulua nga PZAP-ja pas ankesës së KDI-së. Ndonëse vendimi i PZAP-së e korrigjoi këtë çështje para se ajo të prodhonte pasoja në procesin e votimit, KQZ-ja nuk kishte bërë mjaftueshëm për të korrigjuar njoftimin paraprak për lejimin e votimit me dokumente me afat të skaduar. Për më tepër, mbetet e paqartë mënyra dhe niveli i komunikimit të këtij informacioni me stafin zgjedhor në përfaqësitë diplomatike ku u zhvillua votimi.



Vendimi për lejimin e identifikimit të votuesve jashtë Kosovës me dokumente të skaduar ishte një tjetër rast ku KQZ-ja tejkaloj bazën ligjore. Ky vendim u anulua nga PZAP-ja pas ankesës së KDI-së². Ndonëse vendimi i PZAP-së e korrigjoi këtë çështje para se ajo të prodhonte pasoja në procesin e votimit, KQZ-ja nuk kishte bërë mjaftueshëm për të korrigjuar njoftimin paraprak për lejimin e votimit me dokumente me afat të skaduar. Për më tepër, mbetet e paqartë mënyra dhe niveli i komunikimit të këtij informacioni me stafin zgjedhor në përfaqësitë diplomatike ku u zhvillua votimi.

Gjithashtu, KQZ-ja nuk arriti ta zgjidhë në mënyrë të qëndrueshme çështjen e administratës zgjedhore në komunat veriore. Mungesa e Zyrarëve Ekzekutivë Komunalë Zgjedhorë në këto komuna u mbulua përsëri përmes zgjidhjeve të përkohshme.


Çështje tjetër problematike ishte Rregullorja për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, përmes së cilës KQZ-ja vendosi kërkesa shtesë për akreditimin e organizatave vëzhguese.

DnV vlerëson se disa nga këto kërkesa shkojnë përtej asaj që parasheh Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe e rëndojnë pa nevojë procesin e akreditimit të organizatave të shoqërisë civile. Rregullimi i vëzhgimit duhet të sigurojë transparencë dhe rregull, por pa e kthyer akreditimin në proces të panevojshëm kontrolli administrativ mbi organizatat vëzhguese.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se KQZ-ja dhe Sekretaria-ti i saj administruan zgjedhjet e 7 qershorit në mënyrë profesionale dhe me përmirësime të dukshme krahasuar me proceset e fundit zgjedhore. Informimi i rregullt i publikut, funksionimi më i mirë i sistemeve të të dhënave, koordinimi më i mirë teknik dhe vendimmarrja më pak e kontestuar ndikuan pozitivisht në cilësinë e administrimit. Mangësitë e evidentuara, përfshirë vendimet që u korrigjuan nga mekanizmat e drejtësisë zgjedhore, rregulloren për vëzhguesit, përdorimin e qarkoreve elektronike dhe administrimin në komunat veriore, nuk e cenuan integritetin e përgjithshëm të procesit, por përbëjnë çështje që duhet të adresohen në proceset e ardhshme.


2 Vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZP. Anr.19/2026, i datës 5 qershor, 2026. Qasur më 08.07.2026 në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51968.pdf>

Rifreskimi i listave të kandidatëve me të rinj nga partitë kryesore



Ky nivel ndryshimi tregon se partitë politike, edhe pse garuan në një proces të përsëritur zgjedhor brenda një periudhe të shkurtër, nuk hynë në garë me lista krejtësisht të ricikluara. Në veçanti, LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja bënë ndërhyrje më të mëdha në përbërjen e listave të tyre.

Mosha mesatare e kandidatëve të certifikuar ishte 42 vjeç.



Kjo shpërndarje tregon se pjesa më e madhe e kandidatëve i përkasin moshës 31 deri në 50 vjeç, ndërsa kandidatët shumë të rinj dhe ata mbi 60 vjeç përbëjnë pjesë më të vogël të listave.

4.2 Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve

Komisionet Komunale Zgjedhore janë hallka kryesore ndërmjet KQZ-së dhe administrimit të zgjedhjeve në terren. Ato bartin përgjegjësi për organizimin teknik të procesit në nivel komunal, përfshirë shërbimin ndaj votuesve, përgatitjen e qendrave të votimit, koordinimin e trajnimeve, pranimin dhe shpërndarjen e materialeve zgjedhore, si dhe mbështetjen e Këshillave të Vendvotimeve gjatë ditës së zgjedhjeve.

Këshillat e Vendvotimeve administrojnë procesin e votimit në secilin vendvotim. Roli i tyre përfshin hapjen e vendvotimit, verifikimin e votuesve, lëshimin e fletëvotimeve, ruajtjen e rendit brenda vendvotimit, mbrojtjen e fshehtësisë së votës dhe dorëzimin e materialeve pas përfundimit të votimit.

DnV nuk ka zhvilluar monitorim të vazhdueshëm dhe të strukturuar të punës së të gjitha Komisioneve Komunale Zgjedhore gjatë periudhës përgatitore. Për këtë arsye, vlerësimi për këtë pjesë mbështetet kryesisht në vendimet dhe informacionet publike të KQZ-së, në të dhënat e raportuara nga vëzhguesit në ditën e zgjedhjeve, si dhe në çështjet që u evidentuan gjatë administrimit të votimit dhe fazave të para pas mbylljes së vendvotimeve.

Nga të dhënat e disponueshme, funksionimi i KKZ-ve dhe KVV-ve nuk u shoqërua me probleme të mëdha organizative. Vendvotimet u hapën përgjithësisht me kohë, materialet zgjedhore ishin në dispozicion dhe procesi i votimit u zhvillua pa ndërprerje serioze. Rastet e vonesave në hapje ishin të kufizuara dhe, në pjesën më të madhe, lidhen me mungesën e ndonjë anëtarë të KVV-së apo me çështje teknike në vendvotime të caktuara.

Megjithatë, dita e zgjedhjeve tregoi se disa dobësi në organizimin praktik të procesit vazhdojnë të përsëriten. Më e theksuara ishte vështirësia e një numri të konsiderueshëm votuesish për ta gjetur vendvotimin e saktë. Ky problem nuk lidhet vetëm me informimin qendror nga KQZ-ja, por edhe me mënyrën se si votuesit orientohen në qendrat e votimit, sidomos në komunat më të mëdha dhe në qendrat me numër më të madh vendvotimesh.

Edhe qasja e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit mbeti problem i përsëritur. Një pjesë e qendrave të votimit vazhduan të mos ofrojnë kushte të përshtatshme për qasje të lehtë dhe të pavarur. Kjo

çështje kërkon trajtim më të hershëm nga administrata zgjedhore, në bashkëpunim me komunat dhe institucionet që menaxhojnë objektet publike që përdoren për votim.

Në komunat veriore, administrimi zgjedhor vazhdoi të mbështetet në zgjidhje të përkohshme për shkak të mungesës së Zyrtarëve Ekzekutivë Komunalë Zgjedhorë. Edhe pse këto zgjidhje mundësuan zhvillimin e procesit, ato nuk përbëjnë model të qëndrueshëm për administrimin e zgjedhjeve në nivel komunal. KQZ-ja duhet ta trajtojë këtë çështje si pjesë të funksionalizimit të rregullt të administratës zgjedhore, dhe jo si problem që zgjidhet vetëm në prag të zgjedhjeve.

Në vlerësimin e DnV-së, KKZ-të dhe KVV-të arritën t'i përmbushin detyrat themelore për organizimin dhe administrimin e votimit. Mangësitë e evidentuara nuk ndikuan në integritetin e përgjithshëm të procesit, por tregojnë se shërbimi ndaj votuesve, qasja në qendrat e votimit dhe administrata zgjedhore në komunat veriore kërkojnë trajtim më të qëndrueshëm në proceset e ardhshme.

4.3 Puna në Qendrat Komunale të Numërimit

Qendrat Komunale të Numërimit janë një nga ndryshimet më të rëndësishme të administrimit zgjedhor pas reformës së fundit ligjore. Përmes tyre, numërimi i votave për kandidatët është zhvendosur nga vendvotimet në nivel komunal, me synimin që procesi të zhvillohet në kushte më të kontrolluara, me më shumë hapësirë për vëzhgim dhe me mundësi më të mirë për verifikim të të dhënave. Në këto qendra bëhet pranimi i materialit zgjedhor nga vendvotimet, verifikimi i votave për subjekte politike, numërimi i votave për kandidatët, plotësimi i formularëve përkatës dhe dërgimi i të dhënave drejt Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve.

Në zgjedhjet parlamentare të 7 qershorit 2026, puna në QKN shënoi përmirësim të dukshëm krahasuar me proceset e fundit zgjedhore. Për dallim nga zgjedhjet para-prake, kjo fazë nuk u shoqërua me vonesa të mëdha në nisje, ndonjë problem procedural apo paqartësi rreth mënyrës së funksionimit të qendrave. Gabimet e evidentuara ishin kryesisht teknike, procedurale ose njerëzore, të përqendruara në tavolina dhe vendvotime të caktuara.

> DnV e ka vëzhguar punën e QKN-ve përmes rreth

100 vëzhguesve të angazhuar në terren.

> Të dhënat e këtij nënkapitulli mbështeten nga raportimet e drejtpërdrejta nga vëzhguesit në terren, në mbi 500 tavolina të monitoruara, si dhe në 50 formularë incidentesh të raportuar.

> Vlerësimi i përgjithshëm i DnV-së në raport me punën e QKN-ve është pozitiv. QKN-të funksionuan si hapësira më të kontrollueshme dhe më transparente për numërimin e votave të kandidatëve. Në shumicën dërrmuese të segmenteve të monitoruara, vëzhguesit kanë pasur mundësi ta shohin qartë fletëvotimin në ekran dhe regjistrimin e tij në sistem.



Të dhënat e vëzhgimit dhe rezultatet e rinumërimit nuk tregojnë model të organizuar të ndërhyrjes, presionit apo manipulimit të numërimit në QKN.

Në shumicën e komunave, numërimi filloi dhe vazhdoi me ritëm të qëndrueshëm, me prani të rregullt të zyrtarëve të sigurisë, me organizim më të mirë të hapësirës së numërimit dhe me qasje të mjaftueshme për vëzhguesit.

DnV e ka vëzhguar punën e QKN-ve përmes rreth 100 vëzhguesve të angazhuar në terren. Të dhënat e këtij nënkapitulli mbështeten nga raportimet e drejtpërdrejta nga vëzhguesit në terren, në mbi 500 tavolina të monitoruara, si dhe në 50 formularë incidentesh të raportuar.

Vlerësimi i përgjithshëm i DnV-së në raport me punën e QKN-ve është pozitiv. QKN-të funksionuan si hapësira më të kontrollueshme dhe më transparente për numërimin e votave të kandidatëve. Në shumicën dërrmuese të segmenteve të monitoruara, vëzhguesit kanë pasur mundësi ta shohin qartë fletëvotimin në ekran dhe regjistrimin e tij në sistem.

Në këtë aspekt, përdorimi i kamerave dhe monitorëve ka qenë ndër elementet më të rëndësishme të procesit. Në pothuajse të gjitha tavolinat e monitoruara, kamerat dhe monitorët përkatës kanë qenë funksionalë në të gjitha tavolinat aktive, derisa në 11 raste është raportuar se ato kanë qenë funksionale vetëm në disa tavolina. Vetëm në një raportim është evidentuar se kamerat dhe monitorët nuk kanë qenë funksionalë për një periudhë rreth 1 orësh.

Problemet teknike megjithatë ishin të pranishme, sidomos në fillim të procesit. Vëzhguesit kanë raportuar raste të izoluara të kamerave që nuk jepnin pamje të qartë, monitorëve që nuk funksiononin, ndërprerjeve të internetit, problemeve me sistemin apo softuerin, si dhe ndërprerje të energjisë elektrike në raste të caktuara. Sipas raportimeve të vëzhguesit, pjesa më e madhe e problemeve lidhej me fazën e nisjes dhe përshtatjes teknike, ndërsa procesi u stabilizua në ditët pasuese.

Megjithatë, këto probleme nuk paraqesin cenim të integritetit të procesit. Në shumicën e rasteve, ato shkaktojnë vonesa, përsëritje të regjistrimit ose nevojë për ndërhyrje teknike. Kur gabimet janë vërejtur gjatë procesimit, ekipet kanë rinisur procesin për subjektin apo

vendvotimin përkatës dhe kanë vazhduar me regjistrim të ri në sistem. Ky reagim është i rëndësishëm, sepse tregon se sistemi ka pasur mundësi korigjimi gjatë procesit dhe jo vetëm pas përfundimit të tij.

Në aspektin e rendit dhe sjelljes së akterëve brenda QKN-ve, procesi ishte përgjithësisht i qetë. Është raportuar se në hyrje të të gjitha QKN-ve ka pasur prani të zyrtarëve policorë, që janë kujdesur për evidentimin e pjesëmarrjes, dhe në përgjithësi sigurinë në QKN. Vëzhguesit nuk kanë raportuar ndërhyrje apo presion ndaj ekipeve të numërimit nga persona jashtë ekipit. Debatet e ashpra apo incidentet e sigurisë janë raportuar vetëm në raste të rralla.

Qasja e vëzhguesve në proces ishte përgjithësisht e mirë. Megjithatë, në disa raste të izoluara, është raportuar për kufizim kufizimin të lëvizjes së vëzhguesit ndërmjet tavolinave në QKN.

Pjesa më e ndjeshme e punës në QKN lidhet me saktësinë e regjistrimit të votave për kandidatët. Të dhënat e pranua nga vëzhguesit e DnV-së tregojnë se mospërputhjet ndërmjet fletëvotimit të shfaqur në ekran dhe regjistrimit në sistem janë raportuar në 12 tavolina të monitoruara. Incidentet përkatëse tregojnë se këto raste kishin kryesisht natyrë të gabimeve njerëzore gjatë leximit apo futjes së të dhënave, si ndërrimi i numrave të kandidatëve, mosleximi i një fletëvotimi, regjistrimi i gabuar i votës për kandidat apo ngatërrimi i votës së një subjekti me një subjekt tjetër. Në disa raste, procesi është kthyer nga fillimi për subjektin përkatës dhe gabimet janë korigjuar. Për më tepër, të dhënat e vëzhgimit nuk tregojnë model të organizuar të ndryshimit të votave të kandidatëve.

Votat e paqarta apo kontestuese janë raportuar në 36 raste, ndërsa kundërshtime apo ankesa gjatë procesit janë evidentuar vetëm në tri raste. Ky është tregues pozitiv për pranimin e vendimeve të tavolinave të numërimit nga akterët e pranishëm. Në një proces ku numërohen vota preferenciale dhe ku secila votë mund të ketë rëndësi për kandidatët, numri kaq i ulët i kundërshtimeve tregon se shumica e vendimeve në tavolina janë pranuar pa kontestime.

Sa i përket materialit zgjedhor dhe shiritave të sigurisë, procesi ishte përgjithësisht i rregullt. Mospërputhje të numrave apo kodeve të shiritave të sigurisë janë raportuar vetëm në raste të kufizuara. Në fund të procesimit,

në shumicën dërrmuese të segmenteve është raportuar se formularët përkatës janë plotësuar dhe nënshkruar nga numëruesit, si dhe se janë vendosur dhe shënuar shiritat e rinj të sigurisë pas mbylljes së materialit. Kjo tregon disiplinë të mirë procedurale në fazën e mbylljes së kutive dhe materialit zgjedhor.

Sa i përket incidenteve, raportimet e vëzhguesve nga terreni tregojnë se janë dy kategori që janë më të shprehura, respektivisht problemet teknike dhe gabimet në numërim apo regjistrim të votave, me nga 19 raportime secila. Katër incidente lidhen me materialin zgjedhor apo shiritat e sigurisë, tri me pengim të vëzhgimit, tri me formularët dhe rezultatet, një me rendin dhe sigurinë në QKN dhe një me ndërhyrje të paautorizuar. Kjo tregon se natyra kryesore e incidenteve nuk lidhet me presion politik apo cenim të qasjes në proces, por me saktësinë teknike dhe operative të numërimit.

Edhe raporti i Sekretariatit të KQZ-së për rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta e mbështet këtë vlerësim. Rinumërimi përfshiu 185 vendvotime, apo 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotimeve të rregullta. Procesi filloi më 18 qershor dhe përfundoi më 19 qershor. Pas rinumërimit, ndryshime në votat e subjekteve politike u evidentuan në 27 vendvotime në 16 komuna. Ndryshimi absolut te subjektet politike ishte 56 vota, ndërsa ndryshimi efektiv ishte rritje neto prej 16 votash.

Ky nivel ndryshimi është shumë i ulët për një rinumërim prej 185 vendvotimesh. Në 21 vendvotime, ndryshimi lidhej me rivlerësimin e vlefshmërisë së fletëvotimeve, ku 25 fletëvotime që më parë ishin trajtuar si të pavlefshme u vlerësuan si të vlefshme, ndërsa 9 fletëvotime të vlerësuara si të vlefshme në QKN u shpallën të pavlefshme. Në gjashtë vendvotime të tjera, rinumërimi evidentoi raste kur votat e një subjekti politik ishin numëruar gabimisht për një subjekt tjetër, pa ndikuar në numrin e përgjithshëm të votave të vlefshme.

Ndryshimet në votat e kandidatëve ishin më të shumta në numër, por të kufizuara në peshë. Sipas raportit të Sekretariatit, ndryshime janë evidentuar te 547 kandidatë. Te 388 kandidatë janë evidentuar gjithsej 1,197 vota më pak, ndërsa te 447 kandidatë janë evidentuar 1,634 vota më shumë. Ndryshimi absolut ishte 2,831 vota, apo 1.4% e gjithsej 201,423 votave të vlefshme për kandidatë në vendvotimet e rinumëruara. Për 355 kandidatë nuk është evidentuar asnjë ndryshim.

Më e rëndësishme është natyra e këtyre ndryshimeve. Raporti i Sekretariatit tregon se 92% e dallimeve ishin dallime prej vetëm një vote për kandidat në një vendvotim. Dallimet më të mëdha ishin të rralla, ndërsa ndryshimi maksimal ishte katër vota për një kandidat në një vendvotim. Këto gjetje përputhen edhe me raportimet nga vëzhguesit e DnV-së nëpër QKN, sipas së cilave, gabimet e evidentuara ishin kryesisht gabime të vogla njerëzore në lexim, kategorizim apo regjistrim, dhe jo devijime që do të ndryshonin vlerësimin e përgjithshëm për integritetin e procesit.

Në anën tjetër, sipas vëzhgimit të punës së QKN-ve por sidomos rinumërimit të 7.4% të vendvotimeve, u vunë në pah edhe disa gjetje duhet të trajtohen tutje nga organet kompetente. Janë raportuar dyshime për ngjashmëri të nënshkrimeve në vendvotime në Graçanicë dhe Ranilug, fletëvotime me simbole të dyshimta në Ranilug, si dhe fletëvotime me mënyrë të ngjashme plotësimi në Kllokot.

Në vlerësimin e DnV-së, krahasuar me proceset paraprake, procedurat e administruara nëpër QKN shënuan përmirësim në organizim, transparencë, kontroll dhe mundësi korigjimi gjatë procesit. Përdorimi i kamerave dhe monitorëve, qasja më e mirë e vëzhguesve, prania e rregullt e sigurisë dhe disiplinimi më i mirë i procedurave të mbylljes kontribuuan në një proces më të besueshëm. Gjetjet nga monitorimi i DnV-së dhe raportet e rinumërimit tregojnë se ndonëse procesi ka ende nevojë për përmirësime praktike, në këtë proces zgjedhor QKN-të funksionuan në mënyrë dukshëm më të qëndrueshme.

4.4 Puna në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

Qendra e Numërimit dhe Rezultateve është hallka përfundimtare e administrimit teknik të rezultateve zgjedhore. Në këtë qendër trajtohen kategoritë e votave që nuk përmbyllen në vendvotime apo në Qendrat Komunale të Numërimit, përfshirë votat me kusht, votat nga jashtë Kosovës, votat e personave me nevoja të veçanta, si dhe proceset eventuale të rinumërimit. QNR-ja ka rol të rëndësishëm edhe në kontrollin e materialeve zgjedhore, verifikimin e formularëve dhe përgatitjen teknike të rezultateve përfundimtare për certifikim nga KQZ-ja.

Në zgjedhjet e 7 qershorit 2026, puna në QNR u zhvillua në mënyrë përgjithësisht të rregullt dhe pa vonesa të mëdha. Procedurat për trajtimin e votave me kusht, votave jashtë Kosovës, votave me postë dhe kategorive të tjera të parapara me ligj u përmbyllën brenda një dinamike relativisht të shpejtë. Kjo fazë e procesit nuk u shoqërua me kontestime të mëdha publike apo me paqartësi që do ta rëndonin shpalljen dhe certifikimin e rezultateve.

QNR-ja kishte kapacitete adekuate për administrimin e procedurave të parapara me ligj. Shtimi i tavolinave të numërimit, organizimi më i mirë i punës dhe koordinimi më i rregullt me Sekretariatin e KQZ-së ndikuan që kategoritë e ndryshme të votave të trajtoheshin pa zvarritje. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme për votat jashtë Kosovës, të cilat në proceset e mëhershme kanë qenë ndër segmentet më të ndjeshme dhe më të kontestuara të fazës paszgjedhore.

Transparenca e procesit ishte po ashtu më e mirë. KQZ-ja publikoi njoftime të rregullta për ecurinë e punës në QNR dhe për fazat kryesore të numërimit. Publikimi gradual i të dhënave në platformën e rezultateve u dha subjekteve politike, mediave dhe qytetarëve mundësi më të mirë për ta përcjellë procesin.

Në vlerësimin e DnV-së, QNR-ja i administroi me sukses procedurat kryesore që bien në përgjegjësinë e saj. Votat me kusht, votat nga jashtë Kosovës, votat me postë, votat e tjera të parapara me ligj dhe rinumërimet u trajtuan pa vonesa dhe pa probleme që do të ndikonin në integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Përmirësimi i kapaciteteve të numërimit dhe informimi më i rregullt publik kontribuuan që kjo fazë të përmbyllet më qartë dhe më shpejt sesa në proceset paraprake.

4.5 Votimi jashtë vendit

Votimi jashtë Kosovës mbeti një nga segmentet më të rëndësishme të procesit zgjedhor, si për shkak të numrit të lartë të votuesve të regjistruar, ashtu edhe për shkak të ndjeshmërisë politike që ky proces ka pasur në ciklet e fundit zgjedhore. Në zgjedhjet e 7 qershorit 2026, administrimi i këtij procesi ishte më i rregullt dhe më pak i kontestuar sesa në zgjedhjet paraprake.

Periodha e regjistrimit të votuesve jashtë Kosovës filloi më 6 maj dhe përfundoi më 17 maj 2026. Gjatë kësaj periudhe, KQZ-ja pranoi 142,803 aplikime për regjistrim, që përbën numër rekord të aplikimeve. Pas shqyrtimit të aplikimeve, u aprovuan 132,212 kërkesa, u refuzuan 10,497, ndërsa 94 kërkesa u anuluan. Nga kërkesat e refuzuara, numri më i madh lidhej me mungesën e dokumentit që dëshmon adresën e banimit jashtë Kosovës, mungesën e fotografisë me dokument identifikues, mungesën e dokumentit identifikues të Kosovës, mospërputhjen e adresës së deklaruar me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe mangësi të tjera formale gjatë aplikimit. Këto të dhëna janë pjesë e raportit të KQZ-së për certifikimin e Listës së Votuesve, të miratuar më 21 maj 2026.

Nga 132,212 votuesit e regjistruar jashtë Kosovës, 100,970 u regjistruan për të votuar përmes postës në kutitë postare jashtë Kosovës, 3,518 përmes postës në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, ndërsa 27,724 për të votuar fizikisht në përfaqësi diplomatike. Këto shifra tregojnë se votimi me postë vazhdon të jetë forma dominuese e pjesëmarrjes së diasporës, ndërsa votimi fizik në përfaqësi diplomatike mbetet formë e rëndësishme, por më e kufizuar për shkak të numrit të lokacioneve dhe kapaciteteve të tyre.

Për votimin fizik jashtë Kosovës, KQZ-ja organizoi votimin në 30 përfaqësi diplomatike, prej të cilave 17 ambasada dhe 13 konsullata, me gjithsej 47 vendvotime. Votimi fizik u zhvillua më 6 qershor 2026. Nga 27,724 votues të regjistruar për këtë formë votimi, votuan 22,860 qytetarë, apo 82.46%. Procesi u zhvillua pa probleme të theksuara organizative dhe pa kontestime serioze.

Në anën tjetër, votimi përmes postës u zhvillua nga 21 maji deri më 6 qershor 2026. Për këtë formë votimi ishin të regjistruar 104,488 votues, prej të cilëve 100,970 për dërgim të fletëvotimit në kutitë postare jashtë Kosovës dhe 3,518 për dërgim në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë. Pako të supozuara me fletëvotime u tërhoqën nga kutitë postare të KQZ-së në 22 shtete të ndryshme, si dhe nga kutia postare e KQZ-së në Kosovë.

Më 14 qershor, KQZ-ja përmbylli procesin e vlerësimit të 85,790 pakove të supozuara me fletëvotime. Nga ky numër, 82,809 pako u aprovuan, ndërsa 2,981 u refuzuan. Shkalla e refuzimit ishte relativisht e kufizuar në raport me numrin e përgjithshëm të pakove

Për votimin fizik jashtë Kosovës, KQZ-ja organizoi votimin në 30 përfaqësi diplomatike, prej të cilave 17 ambasada dhe 13 konsullata, me gjithsej 47 vendvotime. Votimi fizik u zhvillua më 6 qershor 2026.

27,724 votues

të regjistruar për këtë formë votimi, votuan 22,860 qytetarë, apo

82.46%.

Procesi u zhvillua pa probleme të theksuara organizative dhe pa kontestime serioze.



Votimi përmes postës u zhvillua nga 21 maji deri më 6 qershor 2026.

Më 14 qershor, KQZ-ja përmbylli procesin e vlerësimit të

85,790

pakove të supozuara me fletëvotime. Nga ky numër, 82,809 pako u aprovuan, ndërsa

2,981 u refuzuan.

Shkalla e refuzimit ishte relativisht e kufizuar në raport me numrin e përgjithshëm të pakove të pranuara,

të pranuara, ndërsa arsyet e refuzimit lidhen kryesisht me mospërmbushjen e kriterëve procedurale për votim përmes postës. Pas vlerësimit, zarfet që përmbanin fletëvotime u sistemuan në 223 kuti votimi sipas komuneve prej nga vinin votuesit e regjistruar.

Numërimi i votave me postë u organizua në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve në 20 tavolina numërimi. Kjo rritje e kapaciteteve të numërimit ndikoi që procesi të zhvillohej me ritëm më të mirë dhe pa vonesa të mëdha.

Në aspektin administrativ, ky proces shënoi përmirësim krahasuar me zgjedhjet e vitit 2025. Regjistrimi i votuesve, votimi fizik në përfaqësi diplomatike, pranimi i pakove postare, vlerësimi i tyre dhe numërimi në QNR u zhvilluan pa shumë politizime dhe përplasje tjera politike. Edhe informimi i rregullt i KQZ-së për ecurinë e procesit ndihmoi që palët e interesuara dhe publiku ta përcillnin më lehtë administrimin e votimit jashtë Kosovës. Ndër çështjet e pakta problematike që karakterizuan këtë proces ishte vendimi i KQZ-së për lejimin e votuesve jashtë Kosovës që të identifikoheshin me dokumente të skaduara.

Pavarësisht administrimit përgjithësisht të mirë, votimi jashtë Kosovës vazhdoi të shfaqë disa çështje që meritojnë vëmendje dhe adresim institucional. Gjatë periudhës së votimit me postë u publikuan në rrjete sociale fotografi dhe video të fletëvotimeve të plotësuar. Në disa raste, pamjet e publikuara krijuan përshtypjen e organizimit të votimit në grupe apo të plotësisht të një numri më të madh fletëvotimesh në të njëjtin ambient. Ndonëse këto raste nuk mund të vlerësohen vetëm mbi bazën e materialeve të publikuara në rrjete sociale, ato duhet të trajtohen nga institucionet përgjegjëse, sepse lidhen me fshehtësinë e votës dhe mundësinë e ndikimit mbi vullnetin e votuesve.

4.6 Certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre

Procesi i certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvillua pa konteste të mëdha dhe pa vendimmarrje që do të ndikonte në barazinë e garës.

Për dallim nga disa procese paraprake, certifikimi nuk u shndërrua në burim të tensioneve politike brenda KQZ-së dhe as në çështje që do të kërkonte ndërhyrje nga mekanizmat e drejtësisë zgjedhore.

Në këto zgjedhje u certifikuan gjithsej 21 subjekte politike dhe 902 kandidatë për deputetë. Nga subjektet e certifikuara, tri ishin të kategorizuara si koalicionë, 17 si parti politike, ndërsa një ishte kandidat i pavarur. Numri i kandidatëve ishte më i ulët krahasuar me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, kur kishin garuar 1,180 kandidatë. Kjo rënie lidhet kryesisht me numrin më të vogël të subjekteve garuese dhe me përbërje më të kufizuara të disa listave të subjekteve të komuniteteve jo-shumicë.

Subjektet kryesore politike shqiptare garuan me lista të plota prej 110 kandidatësh. Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës secila certifikoi nga 110 kandidatë. Lista Serbe garoi me 25 kandidatë. Subjektet tjera të komuniteteve jo-shumicë garuan me lista më të vogla.

Çështje e veçantë në procesin e certifikimit mbetet standardi i përshtatshmërisë juridike të kandidatëve. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e drejta për kandidim kufizohet për personat që në tri vitet e fundit janë dënuar me vendim të formës së prerë me një vit apo më shumë burgim efektiv. Ky standard nuk përfshin kandidatët me aktakuza aktive, as kandidatët me dënime të formës së prerë me gjobë, me kusht apo me burgim nën pragun e përcaktuar ligjor. Për rrjedhojë, në fazën e certifikimit KQZ-ja ka vepruar brenda kufijve të ligjit në fuqi, ndërsa çështja mbetet te standardi ligjor që përcakton se cilat dënime prodhojnë ndalim kandidimi.

Në këtë kontekst, sipas një raporti të Institutit të Kosovës për Drejtësi, nga 902 kandidatë të certifikuar, 25 kandidatë apo 2.77% janë evidentuar si të përfshirë në raste penale.³ Prej tyre, 15 kandidatë kanë aktakuza aktive, ndërsa 13 kandidatë kanë dënime penale të formës së prerë. Në tri raste, të njëjtët kandidatë janë evidentuar si persona që kanë pasur dënime penale dhe njëkohësisht aktakuza aktive. Të dhënat e IKD-së tregojnë gjithashtu se kandidatët e përfshirë në raste penale janë pjesë e listave të tetë subjekteve politike. Sipas të njëjtit raport,

3 Instituti i Kosovës për Drejtësi, "Integriteti i listave zgjedhore, Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 7 qershor 2026", Prishtinë, maj 2026.

25 kandidatët e evidentuar lidhen me gjithsej 29 raste penale. Në ndarjen sipas kapitujve të Kodit Penal, rastet më të shpeshta lidhen me korrupsionin zyrtar dhe veprat kundër detyrës zyrtare, të evidentuara 14 herë. Në nivel të veprave konkrete, IKD evidenton 10 raste për “Përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm”, shtatë raste për “Keqpërdorim të pozitës, detyrës apo autoritetit zyrtar” dhe pesë raste për “Mos raportim apo raportim të rremë të pasurisë, të ardhurave, dhuratave apo detyrimeve financiare”. Krahasuar me zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025, numri i përgjithshëm i kandidatëve të përfshirë në raste penale ka rënë nga 27 në 25, ndërsa numri i kandidatëve me dënime penale është rritur nga 12 në 13 dhe numri i subjekteve politike me kandidatë të tillë nga shtatë në tetë.

Një element i dukshëm i këtij procesi ishte rifreskimi i listave të kandidatëve nga partitë kryesore, krahasuar me zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Në listën e LDK-së, 63% e kandidatëve ishin emra të rinj krahasuar me listën paraprake; në listën e PDK-së 56%; në AAK 54%; në Listën Serbe 44%; ndërsa në LVV 29%. Ky nivel ndryshimi tregon se partitë politike, edhe pse garuan në një proces të përsëritur zgjedhor brenda një periudhe të shkurtër, nuk hynë në garë me lista krejtësisht të ricikluara. Në veçanti, LDK-ja, PDK-ja dhe AAK-ja bënë ndërhyrje më të mëdha në përbërjen e listave të tyre.

Mosha mesatare e kandidatëve të certifikuar ishte 42 vjeç. Sipas grupmoshave, 182 kandidatë ishin deri në 30 vjeç, 237 ishin nga 31 deri në 40 vjeç, 263 nga 41 deri në 50 vjeç, 143 nga 51 deri në 60 vjeç, 40 nga 61 deri në 64 vjeç, ndërsa 37 kandidatë ishin mbi 65 vjeç. Kjo shpërndarje tregon se pjesa më e madhe e kandidatëve i përkasin moshës 31 deri në 50 vjeç, ndërsa kandidatët shumë të rinj dhe ata mbi 60 vjeç përbëjnë pjesë më të vogël të listave.

Në aspektin gjinor, nga 902 kandidatë të certifikuar, 593 ishin burra dhe 309 gra. Gratë përbënin 34.3% të numrit të përgjithshëm të kandidatëve, pra mbi minimumin ligjor prej 30%. Te subjektet kryesore, përfaqësimi i grave ishte po ashtu mbi pragun ligjor. LVV kishte 39 gra në listë, PDK 37, LDK 38, AAK 37, ndërsa Lista Serbe 10 gra nga 25 kandidatë. Megjithatë, përmbushja e kuotës në lista vazhdon të mos mjaftojë për pjesëmarrje të barabartë në fushatë dhe në hapësirën publike, çështje që trajtohet më gjerësisht në pjesën për përfaqësimin e grave në procesin zgjedhor.

Shpërndarja territoriale e kandidatëve tregon përqendrim të lartë në disa komuna më të mëdha. Nga Prizreni vinin 157 kandidatë, nga Prishtina 153, nga Ferizaj 77, nga Peja 68, ndërsa nga Fushë Kosova 55 kandidatë. Këto pesë komuna përbënin pjesën më të madhe të kandidatëve të certifikuar. Në anën tjetër, disa komuna kishin numër shumë të vogël kandidatësh. Parteshi dhe Zubin Potoku kishin nga një kandidat, Zveçani dhe Shtërpca nga dy, ndërsa Hani i Elezit dhe Juniku nga tre kandidatë.

Procesi i certifikimit të kandidatëve vazhdoi të zbatojë standardin ligjor të përshtatshmërisë të vendosur pas ndryshimeve të vitit 2023. Sipas këtij standardi, ndalesa për kandidim lidhet kryesisht me dënimet me burgim efektiv mbi një vit. DnV ka vlerësuar edhe në proceset paraprake se ky standard është i ulët për integritetin e përfaqësimit politik, pasi lejon kandidimin e personave që mund të kenë dënime alternative, gjopa apo procese të hapura, edhe në raste që lidhen me korrupsionin ose keqpërdorimin e detyrës publike.

Në vlerësimin përgjithshëm të DnV-së, certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve për zgjedhjet e 7 qershorit u zhvillua në mënyrë të rregullt dhe pa probleme që do të cenonin garën zgjedhore. KQZ-ja e administroi këtë fazë më qetë se në proceset paraprake, ndërsa subjektet politike patën mundësi të garojnë në përputhje me kërkesat ligjore.

4.7 Certifikimi i listës së votuesve dhe Shërbimi i Votuesve

Lista Votuese për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u certifikua nga KQZ-ja më 21 maj 2026. Sipas të dhënave nga certifikimi i listës, numri i përgjithshëm i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në këtë proces ishte 2,092,174 votues. Krahasuar me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit 2025, lista përmbante 15,884 votues më shumë.

Nga numri i përgjithshëm i votuesve, 1,959,962 ishin të përfshirë në listën e votuesve brenda Kosovës, ndërsa 132,212 ishin regjistruar për të votuar jashtë vendit. Nga votuesit e regjistruar jashtë Kosovës, 100,970 u regjistruan për të dërguar fletëvotimin në kutinë postare jashtë Kosovës, 3,518 për ta dërguar fletëvotimin në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, ndërsa 27,724 për të votuar fizikisht në përfaqësi diplomatike.

Për votimin brenda vendit, KQZ-ja miratoi 911 qendra të votimit për votim të rregullt, me gjithsej 2,498 vendvotime. Për votimin me kusht u miratuan 38 qendra votimi, nga një në secilën komunë, me gjithsej 52 vendvotime. Në total, procesi zgjedhor brenda Kosovës u organizua në 949 qendra të votimit dhe 2,550 vendvotime. Për votimin fizik jashtë vendit, KQZ-ja miratoi votimin në 30 përfaqësi diplomatike, prej të cilave 17 ambasada dhe 13 konsullata, me gjithsej 47 vendvotime.


Në këtë proces, numri i votuesve të rinj ishte 22,685. Prej tyre, 16,934 kishin arritur moshën 18 vjeç pas zgjedhjeve të 28 dhjetorit 2025 dhe kishin të drejtë të votojnë për herë të parë në zgjedhjet parlamentare. Nga ky numër, 8,752 ishin burra dhe 8,182 gra. Pjesa tjetër, prej 5,751 votuesish, përfshinte qytetarë të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil ndërmjet dy proceseve zgjedhore, si dhe qytetarë që kishin rikthyer shtetësinë e Kosovës.

Në këto zgjedhje, nga Lista Përfundimtare e Votuesve u larguan 6,801 persona. Prej tyre, 6,165 u larguan si persona të vdekur, të evidentuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil; 419 për shkak të humbjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës; ndërsa 217 pas pranimit të të dhënave nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Këto përditësime tregojnë se KQZ-ja dhe institucionet përgjegjëse kanë vazhduar pastrimin administrativ të listës, megjithëse saktësia e saj mbetet e varur nga cilësia dhe shkëmbimi me kohë i të dhënave ndërinstitutionale.

Në anën tjetër, shërbimi i Votuesve u zhvillua nga 6 deri më 17 maj 2026. Gjatë kësaj periudhe, votuesit patën të drejtë dhe mundësi të verifikojnë qendrën e votimit ku ishin caktuar dhe të paraqesin kërkesë për ndërrimin e saj. Sipas të dhënave të KQZ-së, u pranuan 11,840 kërkesa për ndërrimin e qendrës së votimit, prej të cilave 11,276 u aprovuan dhe 564 u refuzuan.


Për informimin e votuesve lidhur me qendrën e votimit, KQZ-ja përdori edhe njoftimet përmes mesazheve telefonike. Ky mekanizëm, krahas platformës online për verifikim, u dha qytetarëve mundësi shtesë për t'u informuar para ditës së zgjedhjeve. Megjithatë, gjatë ditës së zgjedhjeve u evidentuan raste të shumta të votuesve që kishin vështirësi për ta gjetur vendvotimin e saktë. Kjo tregon se, pavarësisht certifikimit të rregullt të listës dhe përdorimit të mjeteve të informimit, orientimi praktik i votuesve në qendrat e votimit mbetet problem i përsëritur.


Sipas të dhënave nga certifikimi i listës, numri i përgjithshëm i shtetasve të Kosovës me të drejtë vote në këtë proces ishte



Shpërndarja territoriale e kandidatëve tregon përqendrim të lartë në disa komuna më të mëdha.

Këto pesë komuna përbënin pjesën më të madhe të kandidatëve të certifikuar.



Komuna	Numri i votuesve brenda Kosovës	 
 Deçan	39,885	20,154  19,731 
 Gjakovë	118,486	59,894  58,592 
 Glllogoc	55,711	28,754  26,957 
 Gjilan	102,225	51,487  50,738 
 Dragash	40,340	20,254  20,086 
 Istog	49,258	25,359  23,899 
 Kaçanik	32,132	16,309  15,823 
 Klinë	49,457	25,261  24,196 


Numri i votuesve jashtë Kosovës	Qendrat e votimit	Vendvotimet e rregullta	Qendrat e votimit me kusht	Vendvotimet me kusht
4,168	14	48	1	1
7,387	36	144	1	2
2,466	31	73	1	1
8,950	37	127	1	2
2,175	33	57	1	1
4,091	22	60	1	1
2,654	21	44	1	1
3,238	21	62	1	1

Komuna	Numri i votuesve brenda Kosovës	 
 Fushë Kosovë	53,732	26,911  26,821
 Kamenicë	31,776	16,170  15,606
 Mitrovicë e Jugut	80,271	40,737  39,534
 Leposaviq	12,671	6,575  6,096
 Lipjan	63,251	32,359  30,892
 Novobërdë	9,890	5,203  4,687
 Obiliq	25,214	12,950  12,264
 Rahovec	56,705	29,017  27,688

Numri i votuesve jashtë Kosovës	Qendrat e votimit	Vendvotimet e rregullta	Qendrat e votimit me kusht	Vendvotimet me kusht
2,578	16	62	1	2
3,239	28	46	1	1
6,590	32	100	1	2
18	18	25	1	1
4,475	34	83	1	1
261	18	23	1	1
1,319	14	34	1	1
4,900	34	75	1	1

Komuna		Numri i votuesve brenda Kosovës		 			
	Pejë	115,600	58,564		57,036		
	Podujevë	80,917	41,426		39,491		
	Prishtinë	55,711	108,166		111,488		
	Prizren	184,671	92,346		92,325		
	Skënderaj	51,456	26,586		24,870		
	Shtime	26,853	13,684		13,169		
	Shtërpçë	12,221	6,243		5,978		
	Suharekë	66,920	33,633		33,287		

Numri i votuesve jashtë Kosovës	Qendrat e votimit	Vendvotimet e rregullta	Qendrat e votimit me kusht	Vendvotimet me kusht
7,726	30	135	1	2
6,788	47	103	1	2
11,378	54	262	1	6
9,769	76	232	1	3
2,942	33	71	1	1
2,254	15	33	1	1
225	9	17	1	1
6,627	34	86	1	1

Komuna	Numri i votuesve brenda Kosovës	 
 Ferizaj	118,838	59,783  59,055
 Viti	47,306	24,273  23,033
 Vushtrri	72,489	37,245  35,244
 Zubin Potok	6,470	3,412  3,058
 Zveçan	6,977	3,574  3,403
 Malishevë	49,258	25,359  23,899
 Junik	32,132	16,309  15,823
 Mamushë	4,503	2,307  2,196

Numri i votuesve jashtë Kosovës	Qendrat e votimit	Vendvotimet e rregullta	Qendrat e votimit me kusht	Vendvotimet me kusht
9,451	48	146	1	2
4,691	30	62	1	1
6,013	32	89	1	1
85	12	15	1	1
2,175	33	57	1	1
4,091	22	60	1	1
2,654	21	44	1	1
244	1	5	1	1

Komuna	Numri i votuesve brenda Kosovës	
 Hani i Elezit	8,506	4,293  4,213
 Graçanicë	23,969	12,049  11,920
 Ranillug	4,892	2,564  2,328
 Partesh	4,806	2,483  2,323
 Kllokot	4,059	2,128  1,931
 Mitrovicë e Veriut	17,604	8,440  9,164
Gjithsej	1,959,962	991,196 968,766

Numri i votuesve jashtë Kosovës	Qendrat e votimit	Vendvotimet e rregullta	Qendrat e votimit me kusht	Vendvotimet me kusht
467	4	11	1	1
120	14	33	1	1
6	7	10	1	1
0	3	7	1	1
140	5	8	1	1
155	6	21	1	1
132,212	911	2,498	38	52

5. PËRFSHIRJA E GRAVE NË PROCES ZGJEDHOR

Edhe në këto zgjedhje parlamentare, përfaqësimi dhe përfshirja e grave vazhdoi të mbetet nën standardin e barazisë së plotë gjinore në përfaqësimin politik. Ndonëse, kuota minimale prej 30% e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme ka kontribuar në rritjen e pranisë së grave në listat zgjedhore, ajo ende nuk ka reflektuar me një përfaqësim të barabartë gjinor dhe me përfshirje të mjaftueshme të grave në proceset zgjedhore.

Nga gjithsej 902 kandidatë të certifikuar KQZ në këto zgjedhje, 309 ishin gra, që përbënin rreth 34% të të gjithë kandidatëve. Ky nivel përfaqësimi, edhe pse e tejkalon pragun minimal të përcaktuar me kuotën gjinore, tregon se përfshirja e grave në listat zgjedhore vazhdon të mbetet kryesisht e kufizuar në nivelin e kërkesës ligjore, pa reflektuar një angazhim më të madh për arritjen e barazisë së plotë gjinore në garën politike.

Në mesin e subjekteve kryesore politike, Lëvizja Vetëvendosje (LVV) përfshiu 39 gra në listën e kandidatëve, ose rreth 35% të listës së saj, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) përfshiu 38 gra, po ashtu rreth 35%. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) përfshinë nga 37 gra në listat e tyre, që përbënte rreth 34% të kandidatëve. Këto të dhëna tregojnë se, ndonëse subjektet politike kanë garantuar një nivel minimal të përfaqësimit të grave në listat zgjedhore, tejkalimi i kuotës ka mbetur i kufizuar. Në këtë drejtim, hendeuku ndërmjet kuotës minimale zgjedhore prej 30% dhe parimit të barazisë së plotë gjinore prej 50%, të përcaktuar me Ligjin për Barazi Gjinore, vazhdon të mbetet një sfidë për sistemin politik në Kosovë.

Përfaqësimi i grave në institucionet zgjedhore

Nga 12,835 zyrtarë të angazhuar si anëtarë të Këshillave të Vendotimeve në zgjedhjet e 7 qershorit 2026, vetëm 5,081 ishin gra. Në përbërjet e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), nga gjithsej 212 zyrtarë, vetëm 57 ishin gra. Subjekti politik me përfshirjen më të lartë të grave në KKZ ishte Lëvizja Vetëvendosje me 14 apo (36.8%), ndjekur nga

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 11 gra apo 28.9%, Lidhja Demokratike e Kosovës me 7 gra apo në 18.4%, Partia Demokratike e Kosovës me 7 gra apo 16.21%, Za Slobodno Pravdu i Opstanak me 5 gra apo 35.7%, KDTP me 4 gra, në 80%, Lista Serbe 4 gra apo 27.5 %, IRDK me 4 gra apo 42 %, Koalicija Vakati me 1 grua apo 33%, Nova Stranka Demokratska me 1 grua apo 20 % dhe Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës me 1 grua apo 100%. Edhe në nivelet më të larta institucionale, përfaqësimi gjinor mbeti i pabarabartë. Vetëm tri nga 10 anëtarët aktual në KQZ janë gra. Gratë përbënin rreth 26.9% të anëtarëve të komisioneve të vendotimeve – një përqindje ende e ulët për një sistem që synon gjithëpërfshirjen.

Rezultatet dhe përfaqësimi në Kuvend

Rezultatet e zgjedhore tregojnë se në përbërjen e re të Kuvendit të Kosovës do të jenë të përfaqësuara 41 gra deputete, i njëjti numër si në zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025. Nga to, 35 janë zgjedhur përmes votës meritore, ndërsa 6 kanë siguruar mandatin përmes mekanizmit të kuotës gjinore, të paraparë me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në legjislaturën e kaluar u shënua një rritje e pjesëmarrjes së grave në pozita drejtuese parlamentare. Kuvendi u drejtua nga një grua në cilësinë e kryetares, ndërsa dy gra ushtruan funksionin e nënkryetares. Po ashtu, dy grupe parlamentare u udhëhoqën nga gra dhe shtatë komisione parlamentare u kryesuan nga gratë deputete.

Megjithëse këto zhvillime paraqesin progres në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së grave në jetën parlamentare, niveli i përfaqësimit mbetet ende larg parimit të barazisë gjinore. Fakti që numri i grave të zgjedhura ka mbetur i pandryshuar krahasuar me zgjedhjet e mëparshme tregon se progresi në këtë drejtim ka stagnuar. Për më tepër, pjesa më e madhe e grave që fituan mandat i përkasin një subjekti të vetëm politik, gjë që sugjeron se rritja e përfaqësimit nuk është rezultat i një angazhimi të barabartë të të gjitha partive politike për promovimin e grave, por kryesisht pasqyrim i rezultateve zgjedhore dhe strukturës së mandateve të fituara nga ai subjekt.

SUBJEKTI POLITIK			TOTAL
Lëvizja Vetëvendosje	71	39 (35%)	110
Partia Demokratike e Kosovës - PDK	73	37 (34%)	110
Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK	72	38 (35%)	110
Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	73	37 (34%)	110
Ashkalitë e Bashkuar	36	17 (32%)	53
FJALA	12	7 (37%)	19
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës-IRDK	30	14 (32%)	44
Jedinstvena Goranska Partija	15	9 (38%)	24
KNRP	11	5 (31%)	16
Koalicija Vakati	20	11 (35%)	31
Kosova Demokratik Türk Partisi - KDTP	14	8 (36%)	22
Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	9	4 (31%)	13

SUBJEKTI POLITIK			TOTAL
Nova Demokratska Stranka	19	11 (37%)	30
Partia Liberale Egjiptiane	28	13 (32%)	41
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës - PREBK	23	11 (32%)	34
PSA	44	22 (33%)	66
Socijaldemokratska Unija - SDU	16	11 (41%)	27
Srpska Lista	15	10 (40%)	25
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	7	3 (30%)	10
PSD	4	2 (33%)	6
Esmir Kasi	1	0 (0%)	1
TOTAL	593	309 (34%)	902

TABELA 3: Përbërja gjinore e listave të certifikuara të subjekteve politike

SUBJEKTI POLITIK			TOTAL
LVV- Lëvizja Vetëvendosje!	24	14 (36.84%)	38
Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës	27	11 (35%)	38
LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës	31	7 (35%)	38
Partia Demokratike e Kosovës	31	6 (35%)	37
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	9	5 (35%)	14
KDTP	1	4 (35%)	5
Lista Serbe	10	4 (35%)	14
IRDK	4	3 (35%)	7
Koalicia Vakut	2	1 (35%)	3
NDS	4	1 (35%)	5
Levizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	0	1 (100%)	1
Socijaldemokratska Unija - SDU	2	0 (0.00%)	1
Jedinstvena Goranska Partija	1	0 (0.00%)	1
PSA	5	0 (0.00%)	1
PLE	4	0 (0.00%)	0

TABELA 4: Përbërja gjinore e Komisioneve Komunale Zgjedhore

6. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Vëzhgimi i zgjedhjeve për procesin e 7 qershorit 2026 u realizua nga subjekte politike, organizata vendore të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare, media vendore dhe ndërkombëtare, përfaqësi diplomatike dhe një institucion vendor. Sipas vendimeve të KQZ-së, numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar për këtë proces ishte 16,543.

KQZ-ja fillimisht akreditoi grupin e parë prej 761 vëzhguesish. Më 2 qershor 2026, në mbledhjen e 60-të, u akreditua edhe grupi i dytë prej 15,782 vëzhguesish. Pas këtyre vendimeve, procesi zgjedhor u mbulua nga 14,925 vëzhgues të subjekteve politike, 796 vëzhgues të 13 OJQ-ve vendore, 130 vëzhgues të katër organizatave ndërkombëtare, 457 vëzhgues të 39 mediave vendore, 78 vëzhgues të 23 mediave ndërkombëtare, 90 vëzhgues të gjashtë përfaqësive diplomatike dhe 67 vëzhgues të një institucioni vendor.

Pjesa më e madhe e vëzhguesve të akredituar u përkisnin subjekteve politike. Lëvizja Vetëvendosje kishte 3,879 vëzhgues, PDK-ja 3,789, LDK-ja 3,253 dhe AAK-ja 2,541. Kjo prani e gjerë e subjekteve politike në vendvotime dhe në fazat pasuese të procesit kontribuoi në kontrollin e ndërsjellë të procesit nga vetë garuesit zgjedhorë. Në të njëjtën kohë, vëzhgimi vendor nga organizatat e shoqërisë civile mbeti i rëndësishëm për vlerësimin e pavarur të procesit dhe për raportimin publik mbi administrimin e zgjedhjeve.

Akreditimi i vëzhguesve u zhvillua pa vonesa të mëdha dhe pa konteste që do të ndikonin në mundësinë e përgjithshme për vëzhgim të procesit. Numri i lartë i vëzhguesve të akredituar tregon se KQZ-ja, në aspektin praktik, mundësoi prani të gjerë të palëve të interesuara në procesin zgjedhor. Vëzhguesit patën qasje në vendvotime, në qendra të votimit dhe në fazat e numërimit, përfshirë Qendrat Komunale të Numërimit dhe Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, sipas rregullave të akreditimit.

Megjithatë, procesi i akreditimit u zhvillua mbi bazën e Rregullores së re për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, e cila kishte zgjeruar kërkesat administrative për organizatat aplikante. DnV ka vlerësuar se disa nga këto kërkesa

Pjesa më e madhe e vëzhguesve të akredituar u përkisnin subjekteve politike.

	VËZHGUES
LVV	3,879
PDK	3,789
LDK	3,253
AAK	2,541

Kjo prani e gjerë e subjekteve politike në vendvotime dhe në fazat pasuese të procesit kontribuoi në kontrollin e ndërsjellë të procesit nga vetë garuesit zgjedhorë.

DnV vëzhgoi procesin përmes një misioni vendor të shtrirë në fazat kryesore të zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, DnV angazhoi mbi 600 vëzhgues, prej të cilëve 500 në vendvotime të përzgjedhura sipas metodologjisë PVT, si dhe ekipe mobile për përcjelljen e atmosferës në qendrat e votimit dhe përreth tyre.

shkojnë përtej asaj që parasheh Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe e bëjnë procesin e akreditimit më të rënduar se sa është e nevojshme për qëllime të vëzhgimit.

Gjatë shqyrtimit të aplikimeve, KQZ-ja mbështeti rekomandimin për refuzimin e akreditimit të Radio-televizija Vojvodine. Sipas arsytimit të dhënë, aplikuesi ishte paraqitur si media vendore, por nuk figuroi i regjistruar në Komisionin e Pavarur të Mediave apo në Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, ndërsa në vend të certifikatës përkatëse kishte dorëzuar kartelë identifikuese të shtëpisë mediatike.

Në këto zgjedhje nuk pati mision të plotë ndërkombëtar të vëzhgimit të zgjedhjeve, të krahasueshëm me misionet e mëdha të vëzhgimit që zakonisht mbulojnë të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Megjithatë, prania e organizatave ndërkombëtare, përfaqësive diplomatike, mediave ndërkombëtare dhe vëzhguesve vendorë kontribuoi në rritjen e transparencës së procesit. Në këtë kontekst, roli i vëzh-

guesve vendorë ishte veçanërisht i rëndësishëm, sidomos në ditën e zgjedhjeve dhe gjatë numërimit në QKN.

DnV vëzhgoi procesin përmes një misioni vendor të shtrirë në fazat kryesore të zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, DnV angazhoi mbi 600 vëzhgues, prej të cilëve 500 në vendvotime të përzgjedhura sipas metodologjisë PVT, si dhe ekipe mobile për përcjelljen e atmosferës në qendrat e votimit dhe përreth tyre. Pas ditës së zgjedhjeve, DnV vazhdoi vëzhgimin në Qendrat Komunale të Numërimit përmes rreth 100 vëzhguesve në terren, ndërsa ekipet ligjore dhe profesionale përcollën vendimmarrjen institucionale dhe proceset e ankesave.

Në përgjithësi, prania e madhe e vëzhguesve të subjekteve politike, organizatave vendore, mediave dhe përfaqësive ndërkombëtare krijoi mundësi për përcjellje të vazhdueshme të procesit. Vëzhgimi është garanci për besueshmërinë e zgjedhjeve dhe nuk duhet të trajtohet si proces administrativ më i rënduar sesa kërkohet për ruajtjen e rendit dhe integritetit të procesit.

7. DITA E ZGJEDHJEVE

Demokracia në Veprim vëzhgoi ditën e zgjedhjeve përmes 500 vëzhguesve të vendosur në 500 vendvotime, të përzgjedhura sipas mostrës përfaqësuese të rastësishme. Kjo metodologji i mundësoi DnV-së të mbledhë të dhëna të krahasueshme dhe statistikisht të besueshme mbi hapjen e vendvotimeve, ecurinë e votimit, pjesëmarrjen, respektimin e procedurave, fshehtësinë e votës, mbylljen e vendvotimeve dhe rezultatet preliminare për subjektet politike. Përveç vëzhguesve në vendvotime, DnV angazhoi edhe ekupe mobile për përcjelljen e atmosferës në qendrat e votimit dhe përreth tyre.

Procesi i votimit më 7 qershor 2026 u zhvillua në mënyrë të qetë dhe pa incidente serioze që do të cenonin integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Votuesit patën mundësi ta ushtrojnë të drejtën e votës lirisht, ndërsa parregullsitë e evidentuara gjatë ditës ishin kryesisht të natyrës procedurale, teknike ose të lidhura me organizimin praktik në vendvotime dhe qendra të votimit.

Hapja e vendvotimeve u realizua përgjithësisht me kohë. Vetëm 1.6% e vendvotimeve të vëzhguara u hapën me vonesë. Arsytet kryesore lidhen me mungesën e ndonjë komisioneri në momentin e hapjes ose me çështje teknike në vendvotime të caktuara. Këto vonesa ishin të kufizuara dhe nuk ndikuan në zhvillimin e përgjithshëm të votimit.

Në fazën e hapjes u evidentuan edhe disa mangësi teknike. Në rreth 2% të vendvotimeve u raportuan probleme me funksionalizimin ose vendosjen e kamerave. Në raste të caktuara, pozicionimi apo funksionimi jo i duhur i kamerave mund të krijojë shqetësim për fshehtësinë e votës. Po ashtu, në 16% të vendvotimeve nuk kishte asnjë grua në përbërje të Këshillit të Vendvotimit.

Një nga problemet më të shpeshta gjatë ditës ishte vështirësia e votuesve për ta gjetur vendvotimin e saktë. Deri në përmbyllje të procesit, raste të tilla u raportuan në 67% të vendvotimeve të vëzhguara. Në 54% të vendvotimeve u raportuan deri në 10 raste, në 11% u raportuan 11 deri në 30 raste, ndërsa në një numër më të vogël vendvotimesh u evidentuan edhe më shumë raste. Kjo tregon se problemi ishte i përhapur, edhe pse në shumicën e vendvotimeve nuk mori përmasa që do të pengonin seriozisht procesin. Ky problem nuk lidhet vetëm me saktësinë e listës së votuesve.

KQZ-ja kishte mundur verifikimin online të qendrës së votimit dhe kishte përdorur forma shtesë të informimit, përfshirë njoftimet me SMS. Megjithatë, në praktikë, një numër i madh qytetarësh vazhduan të kenë vështirësi për ta gjetur vendvotimin brenda qendrës ku ishin caktuar. Kjo u vërejt sidomos në qendra më të mëdha votimi, ku numri i vendvotimeve brenda një objekti e bën orientimin më të vështirë.

Pjesëmarrja në zgjedhje ishte dukshëm më e ulët se në dy proceset e fundit parlamentare. Sipas të dhënave të DnV-së, dalja në votime deri në mbylljen e vendvotimeve ishte rreth 37%, pa përfshirë votat me kusht dhe votat jashtë Kosovës. Në zgjedhjet parlamentare të 28 dhjetorit 2025, dalja ishte rreth 45%, ndërsa në zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 ishte 44.1%. Rënia e pjesëmarrjes ishte një nga treguesit më të qartë të lodhjes zgjedhore dhe të interesimit më të ulët qytetar për një proces të tretë zgjedhor brenda një periudhe të shkurtër.

Dalja më e ulët nuk u shoqërua me probleme në ushtrimin e së drejtës së votës. Procesi ishte i hapur, konkurrues dhe pa incidente që do të frikësonin apo pengonin votuesit në mënyrë të organizuar. Megjithatë, pjesëmarrja e ulët mbetet zhvillim i rëndësishëm politik dhe demokratik, sepse tregon se zgjedhjet e përsëritura dhe krizat institucionale kanë ndikuar në motivimin e qytetarëve për të marrë pjesë në proces.

Votimi me asistencë u evidentua në përmasa dukshëm më të ulëta se në proceset e mëparshme zgjedhore. Zbatimi më i rreptë i rregullave nga komisionerët ndikoi në kufizimin e kësaj praktike, e cila në zgjedhje të mëhershme kishte qenë një nga fenomenet më problematike të ditës së votimit. Në 66.8% të vendvotimeve u raportua se komisionerët kishin kërkuar dokumente mjekësore ose prova të tjera në deri në 10 raste, ndërsa në 36.8% të vendvotimeve kishte raste kur votuesve nuk u ishte lejuar votimi me asistencë në mungesë të dokumentacionit përkatës.

Rënia e votimit me asistencë përbën zhvillim pozitiv për integritetin e votës. Megjithatë, zbatimi më i rreptë i rregullave duhet të shoqërohet me kujdes që votuesit që realisht kanë nevojë për asistencë të mos pengohen në ushtrimin e të drejtës së votës. DnV evidentoj edhe raste të kufizuara kur votimi me asistencë nuk ishte regjistruar në Librin e Votimit.




Pjesëmarrja në zgjedhje ishte dukshëm më e ulët se në dy proceset e fundit parlamentare.

Rënia e pjesëmarrjes ishte një nga treguesit më të qartë të lodhjes zgjedhore dhe të interesimit më të ulët qytetar për një proces të tretë zgjedhor brenda një periudhe të shkurtër.

7 qershor 2026
37%

28 dhjetor 2025
45%

9 shkurt 2025
44.1%



Rastet e qëndrimit të më shumë se një votuesi prapa kabinës së votimit u raportuan në 15.8% të vendvotimeve. Në shumicën e rasteve bëhej fjalë për numër të vogël rastesh brenda vendvotimit. Megjithatë, kjo praktikë mbetet problematike, sepse prek drejtpërdrejt fshehtësinë e votës dhe mund të krijojë hapësirë për ndikim mbi votuesit.

Gjatë ditës u raportuan 39 raste të fotografimit të fletëvotimit. Ky fenomen vazhdon të jetë shqetësues, edhe kur paraqitet në numër të kufizuar. Fotografimi i votës cenon parimin e fshehtësisë dhe mund të ndërlidhet me presion, blerje vote apo dëshmi të votimit për palë të treta.

Gjatë votimit u evidentuan edhe raste të identifikimit të votuesve me dokumente të Kosovës me afat të skaduar. Raste të tilla u raportuan në 28.6% të vendvotimeve, kryesisht në numër të vogël. Në 26.2% të vendvotimeve u raportuan një deri në katër raste, në 2.2% pesë deri në dhjetë raste, ndërsa vetëm në 0.2% më shumë se dhjetë raste. Kjo tregon se zbatimi i rregullave për identifikimin e votuesve nuk ishte plotësisht i njëtrajtshëm në të gjitha vendvotimet, edhe pse fenomeni nuk mori përmasa që do të ndikonte në vlerësimin e përgjithshëm të procesit.

Qasja fizike në qendrat e votimit mbeti problem për një pjesë të qytetarëve. Sipas vëzhguesve të DnV-së, rreth 19% e qendrave të votimit nuk ofronin kushte të përshtatshme për qasje të lehtë për personat me aftësi të kufizuara fizike. Ky problem është i përsëritur dhe lidhet me përzgjedhjen e objekteve që përdoren për votim,

mungesën e përshtatjeve minimale infrastrukturore dhe mungesën e planifikimit të hershëm me komunat.

Në disa qendra votimi u evidentuan materiale promovuese brenda perimetrit të ndaluar prej 100 metrash. Rastet ishin të kufizuara dhe nuk dominuan dhe nuk e ndikuan atmosferën e ditës së zgjedhjeve.

Mbyllja e vendvotimeve u zhvillua përgjithësisht në mënyrë të rregullt. Në 93.2% të vendvotimeve, mbyllja u bë ndërmjet orës 19:00 dhe 19:15. Vetëm në raste të izoluar vendvotimet u mbyllën para orës 19:00 ose pas orës 19:15. Në vendvotimet ku kishte qytetarë në radhë në momentin e mbylljes, votuesit në përgjithësi u lejuan të votojnë, në përputhje me rregullat zgjedhore. Pas mbylljes së vendvotimeve, materiali zgjedhor u përgatit për dorëzim në Qendrat Komunale të Numërimit.

Në përgjithësi, DnV vlerëson se dita e zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë të qetë, të rregullt dhe pa incidente serioze. Votuesit patën mundësi ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votës, ndërsa administrata zgjedhore në vendvotime arriti ta menaxhojë procesin pa ndërprerje të mëdha. Gjetjet kryesore të ditës lidhen me pjesëmarrjen dukshëm më të ulët, vështirësitë e votuesve për gjetjen e vendvotimit, qasjen e pamjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara, rastet e fotografimit të fletëvotimit dhe zbatimin jo plotësisht të njëtrajtshëm të disa procedurave.

Këto mangësi nuk e cenuan integritetin e përgjithshëm të zgjedhjeve, por tregojnë se administrimi në nivel vendvotimi dhe qendre votimi kërkon përmirësime teknike.

8. REZULTATET ZGJEDHORE

Procesi i shpalljes së rezultateve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026 u zhvillua më shpejt dhe me më pak kontestime sesa në proceset paraprake. Për dallim nga zgjedhjet e vitit 2025, kur publikimi dhe certifikimi i rezultateve u shoqërua me vonesa të gjata, probleme teknike dhe paqartësi publike, këtë herë faza pas ditës së zgjedhjeve ishte më e rregullt.

KQZ-ja publikoi rezultatet preliminare për subjektet politike gjatë natës së zgjedhjeve, pa përsëritjen e problemeve teknike që kishin dëmtuar procesin në zgjedhjet e mëhershme. Platforma për publikimin e rezultateve ishte funksionale dhe u mundësoi qytetarëve, shoqërisë civile, mediave dhe subjekteve politike të përcillnin ecurinë e rezultateve në kohë reale.

Faza e numërimit të votave për kandidatët në Qendrat Komunale të Numërimit gjithashtu u zhvillua me më pak probleme. Procesi nuk u shoqërua me vonesa të mëdha në nisje, ndërprerje të gjata apo pasiguri të përgjithshme procedurale. Problemet e evidentuara ishin kryesisht teknike dhe të lidhura me tavolina apo vendvotime të caktuara, ndërsa në shumicën e rasteve u korrigjuan gjatë procesit. Kjo e bëri fazën e numërimit më të kontrollueshme dhe më pak të kontestueshme se në zgjedhjet e fundit.

Në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, procedurat për votat me kusht, votat e personave me nevoja të veçanta, votat jashtë Kosovës dhe votat me postë u administruan pa vonesa të konsiderueshme. Vlerësimi i pakove postare dhe numërimi i votave jashtë vendit nuk prodhuan krizë procedurale dhe nuk e zvarritën shpalljen e rezultateve përfundimtare. Rritja e kapaciteteve të numërimit dhe informimi më i rregullt i publikut ndihmuan që kjo fazë të përmbyllej në mënyrë më të qartë se në proceset paraprake.

Një pjesë e procesit paszgjedhor ishte edhe rinumërimi i 185 vendvotimeve të rregullta, i vendosur nga KQZ-ja. Ky rinumërim përfshiu 7.41% të vendvotimeve të rregullta dhe u realizua brenda një afati të shkurtër, përkatësisht nga 18 deri më 19 qershor. Rezultatet e rinumërimit treguan ndryshime shumë të kufizuara në votat e subjekteve politike, me ndryshim absolut prej 56 votash dhe

efekt neto prej 16 votash. Ndryshimet në votat e kandidatëve ishin më të shumta, por kryesisht të vogla dhe të lidhura me natyrën më të ndërlikuar të votës preferenciale.

Këto të dhëna e mbështesin vlerësimin se gabimet e evidentuara gjatë numërimit nuk kishin peshë në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Ato tregojnë më shumë për gabime njerëzore dhe procedurale në leximin, kategorizimin apo regjistrimin e votave, sidomos të votave preferenciale, sesa për probleme të strukturuara në administrimin e rezultateve.

Më 27 qershor 2026, KQZ-ja mori vendim për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Shpallja e rezultateve u bë 20 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, këto rezultate u certifikuan më 8 korrik, përkatësisht 31 ditë pas ditës së zgjedhjeve. Ky afat paraqet përmirësim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet e shkurtit 2025, kur certifikimi i rezultateve kishte marrë 46 ditë.

Sipas rezultateve përfundimtare, Lëvizja Vetëvendosje doli subjekti i parë me 382,869 vota, apo 47.13%, duke fituar 53 ulëse. PDK mori 157,892 vota, apo 19.44%, dhe fitoi 22 ulëse. LDK mori 135,567 vota, apo 16.69%, dhe fitoi 18 ulëse, ndërsa AAK mori 54,729 vota, apo 6.74%, dhe fitoi 7 ulëse. Këto katër subjekte fituan të gjitha 100 ulëset jo të garantuara të Kuvendit.

Në ulëset e garantuara për komunitetin serb, Srpska Lista fitoi 9 mandate, ndërsa një mandat iu nda subjektit Za Slobodu Pravdu i Opstanak. Në ulëset e garantuara për komunitetet tjera jo-shumicë, KDTP fitoi dy mandate, ndërsa Koalicija Vakati, IRDK, NDS, SDU, PSA, Partia Liberale Egjiptiane, JGP dhe PREBK fituan nga një mandat.

Përbërja gjinore e Kuvendit të ri tregon se gratë do të përfaqësojnë më shumë se minimumi ligjor prej 30%. Nga 120 deputetë të zgjedhur, 41 janë gra, ose 34.2% e përbërjes së Kuvendit. Kjo e mban përfaqësimin e grave mbi pragun kushtetues dhe ligjor, por ende larg përfaqësimit të barabartë.

Lëvizja Vetëvendosje



47.13%
382,869 vota

Partia Demokratike e Kosovës



19.44%
157,892 vota

Lidhja Demokratike e Kosovës




16.69%
135,567 vota

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës



6.74%
54,729 vota

Këto katër subjekte fituan të gjitha **100 ulëset jo të garantuara të Kuvendit.**



35/41

Nga 41 gratë e zgjedhura, 35 janë zgjedhur përmes votave meritore, ndërsa 6 mandate janë rezultat i aplikimit të kuotës gjinore.

Kjo tregon se në këtë proces shumica e grave të zgjedhura kanë siguruar mandatin drejtpërdrejt përmes votës së qytetarëve.

Nga 41 gratë e zgjedhura, 35 janë zgjedhur përmes votave meritore, ndërsa 6 mandate janë rezultat i aplikimit të kuotës gjinore. Kjo tregon se në këtë proces shumica e grave të zgjedhura kanë siguruar mandatin drejtpërdrejt përmes votës së qytetarëve. Megjithatë, kuota vazhdoi të ketë rol përcaktues në disa subjekte politike dhe mbetet mekanizëm i domosdoshëm për garantimin e përfaqësimit minimal gjinor.

Te LVV, të gjitha 19 gratë e zgjedhura fituan mandat përmes votave preferenciale. Edhe te LDK, të gjashtë gratë e zgjedhura ishin brenda renditjes fituese sipas votave. Ndryshe, te PDK dy nga shtatë gratë e zgjedhura hynë në Kuvend përmes kuotës gjinore. Te AAK, të tri gratë e zgjedhura u përfshinë përmes aplikimit të kuotës. Te Srpska Lista, një nga tri gratë e zgjedhura mori mandat për shkak të kuotës. Këto raste tregojnë se, pavarësisht përmirësimit të votës preferenciale për gratë në disa lista, kuota ende luan rol korrigjues në subjektet ku gratë nuk arrijnë të hyjnë në zonën fituese vetëm përmes votave.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, subjektet politike dhe kandidatët kishin në dispozicion afatin ligjor prej 48 orësh për të paraqitur ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Në këtë fazë u paraqitën pesë ankesa kundër rezultateve. PZAP-i i refuzoi të gjitha ankesat, duke mos konstatuar bazë për ndërhyrje apo ndryshim në rezultatet e shpallura nga KQZ-ja.

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, në PZAP u paraqitën pesë ankesa kundër rezultateve. Dy prej tyre kishin të bënin me votat preferenciale brenda listës së PDK-së dhe kërkonin rinumërim më të gjerë të votave të kandidatëve. Tri ankesat tjera lidheshin me ulëset e garantuara të komuniteteve jo-shumicë dhe kundërshtonin votat e fituara nga subjekte të caktuara në vendbanime ku ankuesit pretendonin se struktura demografike nuk përputhej me profilin komunitar të subjektit përfitues. PZAP i refuzoi të gjitha ankesat, duke vlerësuar se nuk kishte bazë të mjaftueshme për ndërhyrje në rezultatet e shpallura nga KQZ.

Pas vendimeve të PZAP-it, palët kishin të drejtë ankese në Gjykatën Supreme. Palët shfrytëzuan të drejtën e paraqitjes së ankesave dhe në afat ligjor në Gjykatë Supreme u paraqitën ankesat. Palët i replikuan kërkesat e tyre edhe në Gjykatën Supreme, duke kundërshtuar vendimet e PZAP në lidhje me refuzimin e ankesave.

Palët përmes ankesave i kërkuar Gjykata Supreme rinumërim të plotë të votave të kandidatëve brenda subjektit politik PDK dhe u kërkuar që votat e subjekteve politike për ulëset e garantuara në Kuvendin e Kosovës të shqyrtohen për nga vlefshmëria, me pretendimet që partitë e pakicave kanë kërkuar nga Gjykata Supreme të vendos që subjektet politike të pakicave kanë marrë vota në vendet ku nuk është i përfaqësuar ai komunitet për të cilin ato subjekte politike ishin në garë. Tutje Gjykata Supreme, në afat ligjor ka vendosur për refuzimin e të gjitha ankesave si të pa bazuara, duke vërtetuar vendimin e PZAP dhe lënjen në fuqi të vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultateve përfundimtare.

Në vlerësimin e DnV-së, procesi i shpalljes së rezultateve në zgjedhjet e 7 qershorit ishte ndër pjesët më të përmirësuara të këtij cikli zgjedhor. Publikimi i rezultateve preliminare, numërimi në QKN, trajtimi i votave në QNR, rinumërimet dhe shpallja e rezultateve përfundimtare u zhvilluan pa vonesa të mëdha dhe pa probleme që do të cenonin besueshmërinë e rezultatit.

Megjithatë, procesi tregoi se saktësia e votave preferenciale mbetet fusha më e ndjeshme e administrimit të rezultateve. Gabimet e evidentuara nga rinumërimi ishin të kufizuara, por ato lidhen drejtpërdrejt me renditjen e kandidatëve brenda listave dhe për këtë arsye mund të prodhojnë kontestime edhe kur nuk ndikojnë në rezultatit e subjekteve politike. Kësisoj, përgjithësisht, rezultatet e zgjedhjeve të 7 qershorit u administruan në mënyrë më efikase, më transparente dhe më pak të kontestuar se në proceset e fundit zgjedhore.

9. DREJTËSIA ZGJEDHORE

Korniza ligjore e Kosovës parasheh rregulla të detajuara, udhëzime procedurale dhe afate të përsheptuara për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Palët e interesuara kanë të drejtë të kontestojnë përfshirjen ose përjashtimin nga lista e votuesve, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, shkeljet gjatë fushatës, parregullsitë në ditën e votimit dhe numërimin, si dhe rezultatet përfundimtare të shpallura nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) përbën instancën qendrore për trajtimin e kontesteve zgjedhore dhe ka kompetencë të plotë për të shqyrtuar ankesat kundër vendimeve të KQZ-së dhe shkeljeve të rregullave zgjedhore.

Vendimet e PZAP-it janë të apelueshme në Gjykatën Supreme në rastet kur përfshijnë gjoba mbi pragun ligjor ose kur prekin të drejta themelore zgjedhore. Si organ i përhershëm dhe i pavarur, i emëruar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, PZAP funksionon si mekanizëm i specializuar gjyqësor për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe për garantimin e zgjidhjes së shpejtë të kontesteve.

PZAP dhe Gjykata Supreme kanë demonstruar nivel të lartë profesionalizmi dhe konsistence në trajtimin e çështjeve zgjedhore. Vendimet janë marrë brenda afateve të parapara ligjore dhe, në përgjithësi, kanë reflektuar interpretim të qëndrueshëm të dispozitave ligjore. Krahësuar me disa procese të mëhershme zgjedhore, nuk janë evidentuar mospërputhje të theksuara në praktikën vendimmarrëse apo raste që do të krijonin pasiguri juridike për pjesëmarrësit në proces.

Përveç PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, rol të rëndësishëm në mbrojtjen e integritetit të procesit kanë luajtur edhe Prokuroria dhe organet e rendit. Gjatë periudhës zgjedhore janë trajtuar një numër rastesh që lidhen me dyshime për vepra penale kundër të drejtave zgjedhore, përfshirë pretendime për cenim të vullnetit të lirë të votuesve dhe forma të tjera të ndikimit të paligjshëm në procesin zgjedhor.


Në Ditën e Zgjedhjeve, angazhimi i një numri të madh prokurorësh dhe koordinimi me Policinë e Kosovës kontribuan në reagimin e shpejtë ndaj rasteve të raportuara dhe në ruajtjen e besimit publik në proces. Në përgjithësi, DnV vlerëson se sistemi i drejtësisë zgjedhore ka funksionuar në mënyrë efektive gjatë këtij procesi zgjedhor. Qasja profesionale e institucioneve përgjegjëse, respektimi i afateve procedurale dhe efektiviteti e mjeteve juridike kanë kontribuar në zgjidhjen e kontesteve zgjedhore dhe në forcimin e besimit në ligjshmërinë e procesit.

Natyra e vendimeve të PZAP

Në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026, drejtësia zgjedhore u karakterizua nga një numër relativisht i kufizuar ankesash dhe nga mungesa e kontesteve të që do të rrezikonin stabilitetin institucional apo integritetin e procesit. Kjo paraqet një dallim të dukshëm nga disa cikle të mëparshme, ku drejtësia zgjedhore ishte shndërruar në arenë për përplasje të forta politike. Në këtë cikël, ankesat zgjedhore mbetën kryesisht të natyrës administrative dhe disiplinore.

Që nga shpallja e zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit 2026, e deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka pranuar dhe shqyrtuar gjithsej 58 ankesa. Pjesa më e madhe e tyre lidhej me vendimet fillestare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfshirë emërimin proporcional të anëtarëve të Komisioneve Komunale Zgjedhore, certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve, akreditimin e vëzhguesve të organizatave joqeveritare, dhe ankesa mbi anulimin e vendimeve administrative të nxjerra nga ana e KQZ-së.

Në fazën e fushatës dhe paszgjedhore, PZAP ka shqyrtuar gjithashtu ankesa që lidhen me shkeljen e rregullave të fushatës zgjedhore, kontestimet mbi numërimin e votave preferenciale në Qendrat Komunale të Numërimit, si dhe ankesa kundër vendimit përfundimtar për shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve. Struktura e ankesave të paraqitura është si vijon:



- ▼

9

ankesa për përdorim të fëmijëve në fushatë zgjedhore;
- 3

ankesa për vendosjen e materialit zgjedhor në hapësira publike;
- 3

ankesa për shpërndarje ose shfaqje të çfarëdo lloj materiali në një qendër votimi ose në afërsi prej 100 metrash.
- 2

ankesa për nxitje të urrejtjes;
- 1

ankesë për përdorim të resurseve publike;
- 1

ankesë për mbajtje të tubimit politik pa lajmërim në KKZ;

Gjithashtu, PZAP gjatë kësaj periudhe nxorri edhe një vendim tejet të rëndësishëm për të ruajtur ligjshmërinë e procesit të votimit jashtë vendit, duke anuluar kështu vendimin e KQZ-së për lejimin e votimit në përfaqësi diplomatike edhe me dokumente të skaduara.⁴ Ky rast u dërguar nga përfaqësuesit ligjor të DNV-së dhe vendimi në fjalë u konfirmua gjithashtu edhe nga Gjykata Supreme.⁵

Analiza e vendimeve të PZAP-së për shkeljet gjatë fushatës zgjedhore

Deri më 7 qershor 2026, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar gjithsej 19 ankesa lidhur me shkeljet e kryera gjatë fushatës zgjedhore nga ana e subjekteve politike. Nga këto raste, PZAP ka nxjerrë 18 vendime, prej të cilave 9 kanë qenë aprovuese, 7 refuzuese, 1 ankesë e hedhur poshtë si e palejuar dhe 1 ankesë e hedhur poshtë si e pas afatshme.

Për shkeljet e konstatuara të Kodit të Etikës gjatë fushatës zgjedhore, PZAP ka shqiptuar gjoba ndaj subjekteve politike, në vlerë të përgjithshme prej 26,100 eurosh. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre gjobave lidhet me përdorimin e fëmijëve në aktivitetet e fushatës publike.

Lëvizja Vetëvendosje u dënua me 11 mijë e 100 euro gjobë për përdorim të fëmijëve në fushatë dhe atë në tubimet e mbajtura në Vushtrri, Podujevë dhe dy të tjerave në Lipjan.⁶ Lidhja Demokratike e Kosovës, u dënua me 11 mijë euro gjobë për përdorim të fëmijëve në fushatën e tyre të mbajtur në Komunën e Vitisë dhe të Lipjanit.⁷ Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës u dënua me 2 mijë euro gjobë për përdorim të fëmijëve në fushatë për një rast të mbajtur gjatë tubimit në Decan.⁸ Subjekti Politik Lista Serbe u dënua me 2 mijë euro gjobë për vendosje të posterëve në rrugët publike në komunën e Novobërdës.⁹

Kurse, pjesa tjetër e ankesave u refuzuan nga PZAP kryesisht me arsyetimin se ishin si të pabazuara ose u hodhën poshtë si të pas afatshme apo të palejuara.

4 PZAP, vendim i datës 5 qershor 2026. I qasshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51968.pdf>
5 Gjykata Supreme e Kosovës, aktvendim i datës 11 qershor 2026. I qasshëm në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/52125.pdf>
6 PZAP, vendim i datës 6 qershor 2026: <https://smaa.rks-gov.net/documents/51977.pdf>
7 Po aty, <https://smaa.rks-gov.net/documents/51976.pdf>
8 Po aty, <https://smaa.rks-gov.net/documents/51982.pdf>
9 Po aty, <https://smaa.rks-gov.net/documents/51971.pdf>

Në anën tjetër, një element i rëndësishëm i këtij procesi është fakti se gjatë kësaj fushate zgjedhore PZAP nuk ka shqiptuar asnjë vendim me gjobë për shkak të shkeljeve për përdorim të gjuhës nxitëse dhe urrejtëse ndaj subjekteve politike apo kandidatët. Kjo tregon një nivel më të lartë të vetëpërmbytjes dhe pjekurisë në diskursin politik, kryesisht edhe për shkak se kjo situatë reflekton edhe efektin parandalues të praktikës ndëshkuese të viteve të kaluara.

Ankesat dhe vendimet gjatë procedurës së numërimit në QKN dhe QNR

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), lidhur me procesin e numërimit të votave në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) në tërë Kosovën, ka pranuar gjithsej shtatë ankesa të paraqitura nga subjekte të caktuara politike dhe nga votues.

Nga këto shtatë ankesa, PZAP ka nxjerrë pesë vendime refuzuese dhe dy vendime aprovuese. Konkretisht, janë aprovuar dy ankesat e subjektit politik Lista Serbe lidhur me procesin e numërimit në QKN-në e komunës së Ranillugut, ku PZAP ka konstatuar se në këto dy raste fletëvotimet për këtë subjekt politik nuk janë numëruar drejt. Bëhet fjalë për pesë fletëvotime në të cilat ishin vendosur simbolet “=”, “%” dhe “@”, të cilat ishin shpallur të pavlefshme nga QKN-ja në Ranillug.

PZAP ka konstatuar se në këto raste ishte përcaktuar qartë qëllimi i votuesit dhe se shpallja e këtyre pesë fletëvotimeve si të pavlefshme ishte e paligjshme. Për këtë arsye, ai e ka urdhëruar KQZ-në dhe QKN në fjalë, që këto vota të numërohen si të vlefshme dhe të regjistrohen në rezultatet zgjedhore. Ndërkaq, pesë ankesat e tjera u refuzuan si të pabazuara. Këto përfshijnë një ankesë të paraqitur nga një kandidate e LDK-së lidhur me procesin në QKN-në e Pejës, një ankesë të PDK-së ndaj një komisioneri të LVV-së në QKN-në e Ferizajt, një ankesë të Listës Serbe lidhur me procesin në QKN-në e Ranillugut, si dhe dy ankesa të paraqitura nga votuesit A.P. ndaj QKN-së në Kaçanik dhe A.K. ndaj QKN-së në Gjakovë.

10 Shih PZAP vendim në rastin: A.nr.52/26 datë 22 qershor 2026, i publikuar në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/52183.pdf>
11 Po aty, vendim në rastin: A.nr.53/26, datë 22 qershor 2026, i publikuar në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/52184.pdf>

Ankesat në PZAP ndaj rinumërimit në QNR

Sa përket ankesave të ndaj procesit të rinumërimit të votave në QNR, PZAP ka trajtuar gjithsej dy ankesa të parashtruar nga dy kandidatët për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu¹⁰ dhe Qendrim Kryeziu.¹¹

Të njëtit, me ankesat e tyre, pretenduan se KQZ me rastin e vendosjes së rinumërimit të 185 kutive të numëruara në QKN lë hapësirë për të dyshuar faktin se votat e numëruara për deputetë në QKN nuk kanë qenë të sakta. Për më tepër, sipas të njëjtit pas përfundimit të procesit të votimit, votat e kandidatëve për deputet u numëruan në Qendrat Komunale të Numërimit (QKN) ndërsa rezultatet u administruan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë procesit KQZ ka konstatuar se ekzistonin rrethana që kërkonin verifikim shtesë të saktësisë së numërimit të votave për kandidatët për deputet, mbi bazën e kësaj KQZ me vendimin 01/1300-2026 urdhëroi rinumërimin e 185 vendvotimeve të rregullta në Qendrën për Numërim dhe Rezultate. Rinumërimi përfundoi me 19 qershor dhe rezultatet e tij u publikuan nga KQZ.

Sipas pretendimeve të tyre e veçanarisht në ankesën e kandidatit Bekim Haxhiu thuhej që nga të dhënat zyrtare ndonëse janë rinumëruar 185 vendvotime, këto përfaqësojnë vetëm rreth 7.41% të gjithsej 2,498 vendvotime në të cilat janë numëruar votat e kandidatëve për deputet në nivel vendi. Sipas rezultateve nga gjithsej 147,594 vota të fituara nga PDK janë rinumëruar vetëm 5,201 vota që përbëjnë afërsisht 3.52% të të gjithë votave të PDK-së dhe të kandidatëve të saj për deputet, dhe mbi 96.48% e votave të kandidatëve për deputet të PDK-së nuk janë verifikuar përmes procesit të rinumërimit. Sipas ankesave, rezultati i rinumërimit nuk mund të konsiderohet pa verifikim gjithëpërfshirës të saktësisë së numërimit fillestar, kur është kontrolluar vetëm një pjesë minimale e votave të subjektit politik. Këto pretendime të parashtruesve u hodhën poshtë si të pabazuara si nga ana e PZAP e më dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Vendimet nga PZAP dhe Gjykata Supreme

Fillimisht, sipas PZAP por edhe vendimeve të Gjykatës Supreme për rastet në fjalë u sqarua fakti se ankuesit e kanë fare të qartë faktin e praktikës së ndërtuar dhe konsistencës së kësaj praktikë se në cilat raste PZAP-i dhe Gjykata Supreme ka urdhëruar KQZ për rinumërim, apo në cilat raste është aplikuar rinumërimi.¹² Sipas arsyetimeve të vendimeve në fjalë, thuhet që ankuesit në ankesë pretendojnë se ka prova konkrete por që nuk është e qartë se ku janë ato prova konkrete, pasi nëse i referohet vetëm vendimit të KQZ-së për të kthyer një proces numërimi në verifikim dhe rinumër është provë e pamjaftueshme për të aprovuar ankesat dhe kërkesën për rinumërimin.

Për më tepër, edhe Gjykata Supreme me rastin e trajtimit të ankesave kundër vendimeve në fjalë në të dy rastet theksoi se në asnjë rrethanë nuk ka patur arbitraritet në vendimet e atakuar të PZAP-it por ka patur ligjshmëri dhe diskrecion mbështetur në prova sepse është dispozita ligjore që e kufizon PZAP-in pikërisht për të mos qenë arbitrar në vendimmarrje.¹³

Sipas Supremes, pretendimet e ankuesve se vetëm mbi bazën e gabimit të konstatuar nga KQZ-ja në rinumërim dhe rezultatit pas rinumërimit është bazë e mjaftueshme në rastin konkret, kjo nuk përbën bazë të mjaftueshme në rastin konkret për një procedurë të rinumërimit. Proceset zgjedhore janë procese të shpejta, janë procese me afate kohore, ndërhyrja e PZAP-it dhe Gjykatës Supreme në këto procese vjen në shprehje vetëm në rastet e cënimit të së drejtave të kandidatëve apo subjekteve garuese, cenim ky i provuar nga ankuesit qoftë përmes provës konkrete direkte apo provë rrethanore që ngrit një dyshim të bazuar, në të kundërtën përmes këtyre pretendimeve sikurse ky në ankesë nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme.

Ankesat pas shpalljes së rezultateve përfundimtare

Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja më 27 qershor,¹⁴ në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia u parashtruan gjithsej pesë ankesa, ku të

gjitha u refuzuan si të pabazuara. Konkretisht, u parashtruar dy ankesa nga kandidatët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, Bekim Haxhiu dhe Qëndrim Kryeziu; dy ankesa nga subjekti politik Nova Demokratska Stranka-NDS dhe një ankesë nga subjekti politik Lista Serbe.

Në ankesat e parashtruara nga të dy kandidatët për deputetë nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës ata kishin kishin kërkuar rinumërimin e plotë të votave të kandidatëve për deputetë të kësaj partie. Sipas tyre, PZAP duhet të aprovojë ankesat si të bazuara për shkak ka pasur pasaktësi në llogartjen për votat e kandidatëve për deputetë brenda kësaj partie me rastin e numërimit dhe rinumërimit. Kurse, Lista Serbe në ankesën e saj pretendoi se partia e Nenad Rashiqit (ZSPO) arriti një numër votash në komuna, ku sipas regjistrimit të popullsisë së Kosovës të vitit 2024, komuniteti serb praktikisht nuk ekziston. Ngjashëm, edhe subjekti politik NDS është ankuar për partinë e Nenad Rashiq dhe Koalicionin Vakant duke pretenduar se këto dy parti kanë marrë vota në vendvotime ku nuk ka prani të madhe të komunitetit boshnjak dhe atij serb respektivisht.

Vendimet e PZAP mbi ankesat për rezultatet përfundimtare

Më 1 korrik 2026, Paneli Zgjedhor për Ankesat dhe Parashtrësia duke vendosur mbi ankesat e palëve në fjalë vendosi që të gjitha ti refuzoi si të pabazuara, duke lënë në fuqi kështu vendimin e KQZ për shpalljen e rezultateve përfundimtare.¹⁵

Fillimisht mbi ankesat e parashtruara nga kandidatët e subjektit të PDK-së, PZAP me rastin e refuzimit të tyre, konstatoi që procedura e ankesave pas shpalljes së rezultatit përfundimtar ka për qëllim shqyrtimin e pretendimeve të mbështetura në prova konkrete që mund të vënë në dyshim ligjshmërinë ose saktësinë e rezultatit të shpallur, e jo rivlerësimin e çështjeve që tashmë kanë qenë objekt shqyrtimi gjatë fazave paraprake të administrimit dhe verifikimit të procesit zgjedhor. Në këto ven-

dime, thuhet se ankesat janë të bazuara në të dhënat që veçse janë trajtuar paraprakisht nga PZAP-i dhe në njëfar forme përbëjnë çështje të gjykuara.¹⁶ PZAP po ashtu, refuzoi edhe ankesën e Listës Serbe me arsyetimin se pretendimet e saj janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore: barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve dhe se nuk ka bazë ligjore e kushtetuese që të anulohen votat si të pavlefshme për shkak të natyrës së etnicitetit.¹⁷ Për më tepër, PZAP dha arsyetim të ngjashëm edhe me rastin e refuzimit të ankesave edhe të subjektit politik NDS të cilit kishin pretenduar se partia e Nenad Rashiq dhe Koalicioni Vakant kanë marrë vota në lokacione ku nuk ka fare votues të tyre.¹⁸

Pavarësisht këtyre vendimeve nga PZAP, palët në fjalë i kundërshtuan këto vendime në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ankesat dhe vendimet nga Gjykata Supreme

Më 7 korrik 2026, Gjykata Supreme refuzoi si të pabazuara pesë ankesa administrative të paraqitura kundër vendimeve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), lidhur me rezultatet përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me aktgjykimin AA.nr.29/2026, Gjykata Supreme refuzoi ankesën e Listës Serbe kundër vendimit të PZAP-së (ZP.A nr.56/2026), me të cilën pretendohet se subjekti politik “GI – Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” (ZSPO) kishte siguruar mandatin e garantuar për komunitetin serb kryesisht përmes votave të fituara në komuna dhe vendvotime me shumicë shqiptare, duke cenuar përfaqësimin autentik të komunitetit serb. Gjykata vlerësoi se legjis-

lacioni zgjedhor nuk e lidh vlefshmërinë e votës me përkatësinë etnike të votuesit apo strukturën demografike të vendbanimit dhe se ankuesi nuk kishte paraqitur prova konkrete për manipulim të votave apo parregullsi që do të ndikonin në rezultatin zgjedhor.¹⁹

Me aktgjykimet AA.nr.30/2026 dhe AA.nr.31/2026, Gjykata Supreme refuzoi dy ankesat e paraqitura nga kandidatja Emilija Rexhepi (NDS), kundër vendimeve të PZAP-së, A nr.57/2026 dhe ZP.A.nr.58/2026.²⁰ Gjykata ritheksoi se Lista e Votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve, ndërsa KQZ nuk administron të dhëna të tilla, prandaj nuk ekziston bazë kushtetuese apo ligjore që vlefshmëria e votave të vlerësohet mbi bazën e strukturës etnike të vendbanimeve. Gjykata konstatoi gjithashtu se pretendimet mbështeteshin në analiza statistikore dhe jo në prova konkrete për manipulim të votave apo shkelje të procedurave zgjedhore.

Ndërkaq, me aktgjykimet AA.nr.32/2026 dhe AA.nr.33/2026, Gjykata Supreme refuzoi ankesat e kandidatëve të PDK-së, Bekim Haxhiu dhe Qëndrim Kryeziu, të paraqitura kundër vendimeve të PZAP-së ZP. Anr.54/2026 dhe ZP.Anr.55/2026.²¹ Gjykata vlerësoi se raporti i KQZ-së nuk përbënte bazë të mjaftueshme për një rinumërim të përgjithshëm, pasi korrigjimet e evidentuara ishin sporadike dhe nuk cenonin besueshmërinë e rezultatit përfundimtar apo integritetin e procesit zgjedhor. Po ashtu, u theksua se rinumërimi i 185 vendvotimeve ishte realizuar në kuadër të mekanizmave të kontrollit të paraparë me legjislationin zgjedhor dhe jo si pasojë e konstatimit të parregullsive sistematike.²²

12 Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin:A.A.nr.27/2026, datë 26 qershor 2026, i publikuar në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/52185.pdf>
13 Po aty, Gjykata Supreme e Kosovës, vendim në rastin: A.A.nr.28/2026 datë 25 qershor 2026, i publikuar në linkun: <https://smaa.rks-gov.net/documents/52186.pdf>
14 KQZ, njoftimi për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të datës 7 qershor 2026. Publikuar në linkun: <https://kqz-ks.org/dita-e-njezet-1200-mbledhja-e-69-te-kqz-shpalli-rezultatet-perfundimtare-te-zgjedhjeve-per-kuvendin-e-kosoves-7-qershor-2026/>.
15 Shih PZAP vendime refuzuese në rastet: A.nr.54, 55, 56, 57 dhe 58/2025 datë:datë 1 korrik 2026 të publikuar në linkun: <https://pzap.rks-gov.net/category/vendimet/>

16 PZAP vendim në rastet A.nr.54/2026 dhe 55/2026 datë 1 korrik 2026, të qasshme në linqet: https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/ZP.Anr._54-2026-Vendim.pdf dhe https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/ZP.Anr._55-2026-Vendim.pdf
17 Po aty, vendim në rastin: A.nr.56/2026, datë 1 korrik 2026, i qasshëm në linkun: https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/ZP.Anr._56-2026-Vendim.pdf
18 Po aty, vendim në rastin A.nr.57 dhe 58/26, datë 1 korrik 2026, të qasshme në linqet: https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/ZP.Anr._57-2026-Vendim.pdf dhe https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/07/ZP.Anr._58-2026-Vendim.pdf
19 Gjykata Supreme e Kosovës, Aktgjykim në rastin AA.nr.29/2026, i publikuar më datë 7 korrik 2026. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_29_2026_SQ.pdf
20 Po aty, Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimet nr. AA.30 dhe 31/2026, të publikuara më datë 7 korrik 2026. Të qasshme në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_30_2026_SQ.pdf shi edhe vendimin A.nr.31 në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_31_2026_SQ.pdf
21 Gjykata Suprem e Kosovës, aktgjykim në rastin AA.Nr.32/2026 i publikuar më datë 7 korrik 2026. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_32_2026_SQ.pdf
22 Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykim në rastin AA.Nr.33/2026 i publikuar më 7 korrik 2026. I qasshëm në linkun: https://supreme.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/verdicts/SUP_AA%20_33_2026_SQ.pdf

REKOMANDIMET

Duke u bazuar në gjetjet dhe vlerësimet nga vëzhgimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026, Demokracia në Veprim paraqet rekomandimet në vijim, që synojnë përmirësimin e administrimit të zgjedhjeve dhe adresimin e çështjeve të evidentuara gjatë këtij procesi. Rekomandimet lidhen me aspekte si funksionimi i trupave zgjedhore, votimi jashtë Kosovës, numërimi, çështjet lidhur me fushatën, zbatimi i procedurave në vendvotime dhe trajtimi i ankesave zgjedhore.

Megjithatë, DnV vlerëson se procesi i ardhshëm i reformës zgjedhore nuk duhet të kufizohet vetëm në çështje teknike. Kurdo që Kuvendi i Kosovës do ta iniciojë procesin e reformës zgjedhore, diskutimi duhet të përfshijë edhe elemente më të gjera të sistemit zgjedhor, përfshirë **votën preferenciale, zonat zgjedhore, pra-gun zgjedhor, mënyrën e zgjedhjes së Presidentit dhe rregullat tjera që kanë tutje ndikim të drejtpërdrejtë në formimin dhe funksionalitetin e institucioneve.** Në këtë diskutim duhet të përfshihet edhe rishikimi, përkatësisht avancimi i **kritereve të përshtatshmërisë juridike për kandidim**, në veçanti duke ndaluar kandidimin e personave të dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me korrupsionin, keqpërdorimin e detyrës zyrtare ose cenimin e integritetit të funksionit publik – pavarësisht llojit dh lartësisë së dënimit të shqiptuar. Gjithashtu, Kuvendi duhet të hapë diskutimin edhe për **modelin institucional të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**, përfshirë përbërjen, mandatin dhe mënyrën e vendimmarrjes së tij. Në këtë drejtim, duhet të shqyrtohet edhe mundësia e balancimit të përbërjes së KQZ-

së me anëtarë jo-politikë. Këto çështje kërkojnë debat të veçantë politik dhe institucional, të zhvilluar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Në kuadër të reformës së ardhshme zgjedhore, Kuvendi duhet të shqyrtojë edhe mundësinë e kodifikimit të legjislacionit zgjedhor në një dokument të unifikuar, në përputhje me praktikat e rekomanduara nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias. Kjo do ta vendoste reformën zgjedhore mbi një bazë të vetme dhe të harmonizuar, në vend të ndërhyrjeve të pjesshme në ligje, rregullore dhe vendime të ndryshme, të cilat shpesh krijojnë paqartësi për institucionet që i zbatojnë dhe për pjesëmarrësit në proces.

Në anën tjetër, duke qenë se zgjedhjet e 7 qershorit u mbajtën vetëm pak muaj pas procesit paraprak të 28 dhjetorit të vitit 2025, një pjesë e rekomandimeve të dhëna nga DnV pas zgjedhjeve të fundit mbeten të vlefshme. Koha e shkurtër ndërmjet dy proceseve nuk ka mundësuar hapësirë reale për ndryshime ligjore. Megjithatë, ky proces tregoi se disa fusha kanë shënuar përmirësim.

Rekomandimet në vijim u drejtohen institucioneve dhe akterëve që kanë rol të drejtpërdrejtë në miratimin e legjislacionit zgjedhor apo administrimin e procesit zgjedhor, përfshirë Kuvendin e Kosovës, KQZ-në, trupat zgjedhore në nivel lokal, PZAP-in, Gjykatën Supreme, institucionet e drejtësisë dhe sigurisë, subjektet politike, kandidatët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile.

I. Administrimi i zgjedhjeve nga KQZ-ja dhe trupat zgjedhore

1 KQZ-së duhet t'i kufizohet e drejta e marrjes së vendimeve dhe nxjerrjes së akteve lidhur me operacionet zgjedhore gjatë kohës kur të njëjtat janë në zhvillim e sipër, duke garantuar parimin e sigurisë juridike dhe mosndryshimit të rregullave të lojës gjatë saj. Në këtë drejtim, kufizimet duhet të vlejnjë për secilën fazë dhe operacion zgjedhor, të tilla si fushata zgjedhore, votimi jashtë vendit, certifikimi i kandidatëve, dita e zgjedhjeve, numërimi dhe të tjera.

2 Aktet nënligjore të KQZ-së duhet të mbeten brenda autorizimeve që jep ligji. KQZ-ja nuk duhet të vendosë kritere shtesë për subjekte politike, kandidatë, vëzhgues apo media, nëse ato kritere nuk janë të parashikuara në ligj ose nuk dalin qartë nga kompetencat e saj ligjore.

3 Vendimmarrja e KQZ-së mbi rekomandimet e Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike të rregullohet sipas modelit të demokracisë negative. Për çështje si certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve, rekomandimet e Zyrës të konsiderohen të miratuara, përveç nëse kundër tyre votojnë shumica apo 2/3 e anëtarëve të KQZ-së, varësisht nga pragu që përcaktohet me ligj. Në rast të refuzimit, KQZ-ja duhet të japë arsyetim ligjor dhe faktik për mospajtimin me rekomandimin e Zyrës.

4 Vendimmarrja e KQZ-së përmes qarkores elektronike duhet të kufizohet në vetëm çështje teknike dhe procedurale. Vendimet që prekin të drejta të subjekteve politike, kandidatëve, votuesve, mediave apo vëzhguesve duhet të trajtohen në mbledhje publike, me debat, arsyetim dhe votim të regjistruar.

5 Të revidohet Rregullorja e re për Vëzhguesit e Zgjedhjeve, duke lënë në fuqi dispozitat paraprake. Kriteret për akreditimin e vëzhguesve duhet të jenë të qarta, proporcionale dhe të bazuara drejtpërdrejt në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Akreditimi duhet të shërbejë për verifikimin e kushteve ligjore për vëzhgim, jo për vendosjen e kërkesave shtesë administrative që nuk janë të domosdoshme për integritetin e procesit.

6 Sistemi për publikimin digjital të rezultateve zgjedhore të trajtohet si prioritet strategjik i KQZ-së dhe jo si zgjidhje teknike e përgatitur vetëm për secilin proces zgjedhor. KQZ-ja duhet të përcaktojë me rregulla të qarta mënyrën e funksionimit, testimin, mirëmbajtjes, sigurisë dhe auditimit të platformës për publikimin e rezultateve, përfshirë publikimin në kohë reale, ruajtjen e të dhënave, gjurmimin e ndryshimeve dhe mekanizmat rezervë në rast të problemeve teknike.

7 KQZ-ja duhet të publikojë pas çdo procesi zgjedhor një raport paszgjedhor për administrimin e procesit. Raporti duhet të përfshijë vlerësimin e secilës fazë zgjedhore, vendimet kryesore, problemet e evidentuara, kostot, kapacitetet e përdorura, performancën e trupave zgjedhore dhe rekomandimet për përmirësim. Raporti duhet të përfshijë edhe vlerësim të brendshëm për ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet KQZ-së, Sekretariatit dhe trupave zgjedhore në fazat ku janë shfaqur vonesa, paqartësi apo nevojë për vendime shtesë gjatë procesit. Ky dokument duhet të publikohet si standard pas çdo procesi zgjedhor dhe të jetë i ndarë nga raportimi i rregullt vjetor i KQZ-së.

- 8 **Të miratohet një Kod Sjelljeje për Anëtarët e KQZ-së, që sanksionon diskursin dhe gjuhën gjatë mbledhjeve të KQZ-së.** Për të ruajtur integritetin institucional dhe klimën demokratike, duhet të miratohet një kod i sjelljes për anëtarët e KQZ-së, i cili përfshin sanksione në rast të shkeljeve.
- 9 Të zhvillohen **trajnime dhe testime më rigorozë për anëtarët e KVV-ve**, para se të njëjtit të caktohen në vendvotime, në mënyrë që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre të kryhen më me profesionalizëm. Prioritet duhet të kenë procesi i numërimit, si dhe shkeljet më të shpeshta, të tilla si abuzimi me votimin me asistencë, cenimit të fshehtësisë së votimit dhe të ngjashme. Në këtë drejtim, edhe subjektet politike duhet të nominojnë komisionerë me integritet dhe përgatitje të duhur profesionale.
- 10 **Të krijohet një sistem vlerësimi për stafin zgjedhor, i cili pas çdo procesi evidenton performancën e anëtarëve të KVV-ve, stafit të QKN-ve dhe personave të tjerë të angazhuar në administrimin e zgjedhjeve.** Personat me performancë të mirë duhet të kenë përparësi për angazhim në procese të ardhshme, ndërsa personat me shkelje të konfirmuara, neglizhencë në detyrë ose gabime të përsëritura nuk duhet të riangazhohen pa trajnim shtesë, verifikim apo vendim të arsyetuar nga KQZ-ja.

Lista e Votuesve dhe Shërbimi ndaj Votuesve:

- 1 **KQZ-ja, Agjencia e Regjistrimit Civil dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të kenë mekanizëm të rregullt për shkëmbimin e të dhënave që ndikojnë në pastrimin e Listës së Votuesve.** Ky mekanizëm duhet të përcaktojë afate, format të standardizuar të të dhënave dhe përgjegjësi të qarta për përditësimin e listës me personat e vdekur, personat që kanë humbur shtetësinë dhe personat që nuk kanë të drejtë vote sipas vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Verifikimi duhet të kryhet në mënyrë të përhershme, jo vetëm në prag të zgjedhjeve.

- 2 **KQZ-ja duhet të përdorë mekanizma shtesë të informimit për votuesit të cilëve u ndryshohet qendra apo vendvotimi nga një proces zgjedhor në tjetrin.** Përveç platformës online dhe njoftimeve me SMS, votuesit e prekur nga ndryshimet duhet të informohen në mënyrë më të drejtpërdrejtë për qendrën e re, numrin e vendvotimit dhe lokacionin e saktë.

Votimi jashtë Kosovës:

- 1 **KQZ-ja duhet të miratojë protokoll të veçantë për pranimin, transportimin dhe dorëzimin e pakove me fletëvotime nga jashtë Kosovës deri në QNR.** Protokolli duhet të përcaktojë kush i pranon pakot, si regjistrohet numri i tyre, si dokumentohet data dhe vendi i pranimi, si ruhet materiali gjatë transportit dhe si bëhet pranim-dorëzimi në Kosovë. Këto të dhëna duhet të ruhen si pjesë e dokumentacionit zgjedhor dhe, në formë të përmbledhur, të publikohen pas përfundimit të procesit të pranimi të votave nga jashtë Kosovës.
- 2 **KQZ-ja duhet të vendosë mekanizëm për gjurmimin e zarfeve të votimit me postë nga votuesit jashtë Kosovës.** Votuesi duhet të ketë mundësi të verifikojë nëse zarfi i tij është pranuar nga KQZ-ja, në cilën fazë të trajtimit ndodhet dhe nëse është aprovuar apo refuzuar gjatë vlerësimit. Në rast refuzimi, njoftimi duhet të tregojë arsyen konkrete të refuzimit dhe afatin për ankesë, nëse afati ligjor ende është i hapur.
- 3 **Të zbatohet auditim i pavarur dhe sistematik i të gjithë procesit të votimit jashtë vendit pas çdo palë zgjedhjesh.** Ky auditim duhet të përfshijë të dhënat e regjistrimit, procedurat postare dhe rrugën e transportit të zarfeve, si dhe të publikohet për të rritur besueshmërinë publike.
- 4 **Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit duhet të verifikojnë rastet kur ka dyshime se votat me postë nga jashtë Kosovës janë fotografuar, publikuar apo mbledhur në mënyrë të organizuar.** Verifikimi duhet të sqarojë nëse është cenuar fshehtësia e votës, nëse votuesi ka vepruar i lirë dhe nëse ka elemente të veprës penale zgjedhore.

II. Dita e Zgjedhjeve dhe procedurat në vendvotime

- 1 **Të rishikohet dhe standardizohet struktura organizative e Këshillave të Vendvotimeve, duke rikthyer pozitën e komisionerit për kutinë e votimit dhe duke përcaktuar qartë detyrat e secilit anëtar.** Pozita e komisionerit për kutinë e votimit duhet të rikthehet si rol i detyrueshëm, duke garantuar kontrollin e momentit kritik të hedhjes së votës.
- 2 **Të rishikohet përdorimi i ngjyrës matrikuluese, me qëllim garantimin e plotë të fshehtësisë së votës.** Çdo mekanizëm identifikimi i votuesit duhet të jetë i certifikuar dhe në përputhje me të drejtat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e votës. KQZ duhet të orientohet drejt kalimit në identifikim elektronik të votuesve.
- 3 **KQZ-ja, në bashkëpunim me komunat, duhet të sigurojë qendra votimi të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.** Qasja fizike duhet të jetë kriter i detyrueshëm në përzgjedhjen e objekteve që përdoren për votim. Në rastet kur objektet ekzistuese nuk ofrojnë qasje të përshtatshme, duhet të ndërmerren masa të përkohshme praktike para ditës së zgjedhjeve.
- 4 Pas përmbylljes së secilit proces zgjedhor, **Librat e Votimeve**, që janë të vendosura në secilin vendvotim, **duhet të jenë objekt i auditimit nga KQZ-ja**, në mënyrë që të evidentohen dhe trajtohen detajisht parregullsitë që janë hasur gjatë ditës së zgjedhjeve.

III. Numërimi, QKN, QNR dhe publikimi i rezultateve

- 1 **KQZ-ja duhet ta përcaktojë me rregull të veçantë detyrimin për publikimin periodik të progresit të numërimit dhe përpunimit të rezultateve.** Gjatë fazës së numërimit në QKN dhe përpunimit në QNR, KQZ-ja duhet të publikojë në intervale të rregullta të dhëna për numrin e vendvotimeve të numëruara, votat e përpunuara, kutitë apo materialet që janë në verifikim, rinumërimet eventuale

dhe afatet e pritshme për përmbylljen e fazave kryesore. Ky publikim duhet të jetë obligim i paracaktuar dhe jo vendim ad-hoc gjatë procesit.

- 2 **Të vendoset një standard i detyrueshëm për publikimin e të dhënave të detajuara mbi mospërputhjet, rastet e rinumërimit dhe rezultatin përfundimtar të të gjitha kutive që janë trajtuar në QNR.** Publikimi i këtyre të dhënave duhet të jetë në format të hapur dhe të shoqërohet me shpjegime për secilin rast, në mënyrë që të forcohet transparenca dhe besimi publik.
- 3 **Të rishqyrtohet koncepti i zhvendosjes së numërimit në QKN, duke vlerësuar balancën ndërmjet kostos, efektivitetit dhe integritetit të procesit.** KQZ duhet të realizojë një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimit të këtij modeli në integritetin e votës dhe besimin publik, dhe në bazë të kësaj, të vendosë nëse duhet të zgjerohet, modifikohet apo të rikthehet pjesërisht numërimi në vendvotim me mekanizma mbikëqyrës të përforcuar.
- 4 KQZ duhet të orientohet drejt **dixhitalizimit të procesit të numërimit të votave**, duke evituar gabimet njerëzore dhe manipulimet.

IV. Drejtësia zgjedhore

- 1 **PZAP-i, në koordinim me KQZ-në dhe Gjykatën Supreme, duhet të hartojë dhe miratojë një katalog/udhëzues zbatues për gjuhën e urrejtjes, gjuhën nxitëse dhe shprehjet diskriminuese gjatë fushatës zgjedhore, në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare për lirinë e shprehjes.** Dokumenti duhet të shërbejë si referencë zyrtare për trajtimin e ankesave zgjedhore dhe për informimin paraprak të subjekteve politike, kandidatëve dhe mediave. Ai duhet të përmbajë përkufizime, shembuj orientues dhe kritere vlerësimi për dallimin ndërmjet kritikës politike të lejuar, gjuhës së ashpër të fushatës dhe shprehjeve që nxisin urrejtje apo diskriminim ndaj grupeve të mbrojtura. Në hartimin e tij duhet të përfshihen edhe institucionet përkatëse, përfaqësues të mediave, organizatat e shoqërisë civile dhe ekspertë të të drejtave të njeriut.

- 2

Të rishikohen dispozitat mbi gjobat zgjedhore, në mënyrë që sanksionet të lidhen më qartë me llojin dhe peshën e shkeljes. PZAP-i duhet të zbatojë shkallëzim të gjobave për secilin lloj të shkeljes, duke ngushtuar kufijtë minimalë dhe maksimalë që merren parasysh gjatë vendimmarrjes. Po ashtu, duhet të definohen kriteret që merren parasysh gjatë shqiptimit të sanksioneve, përfshirë përsëritjen e shkeljes, përhapjen e saj në publik, përdorimin e mediave apo rrjeteve sociale, ndikimin në garën zgjedhore dhe ndërmarrjen ose jo të masave korrigjuese nga subjekti politik apo kandidati. Kriteret për përcaktimin e gjobave duhet të jenë publike, në mënyrë që vendimmarrja të jetë më e parashikueshme dhe sanksionet të jenë proporcionale me shkeljen.
- 3

Të publikohet një kornizë orientuese për sanksionet zgjedhore. Kjo do të ndihmonte subjektet politike, kandidatët dhe publikun të kuptojnë më mirë se cilat shkelje trajtohen si më të rënda dhe si përcaktohet proporcionaliteti i gjobave.
- 4

Të rriten kapacitetet e PZAP-së përmes rritjes së numrit të stafit dhe sigurimit të burimeve të qëndrueshme teknike dhe financiare. Duke pasur parasysh volumin e ankesave dhe rëndësinë e trajtimit të tyre me efikasitet, duhet të shqyrtohet mundësia për zgjerim të përkohshëm të kapaciteteve të PZAP-it gjatë periudhave zgjedhore, përmes aktivizimit të trupave ndihmëse apo resurseve shtesë/rezervë.
- 5

Të harmonizohen standardet e vendimmarrjes ndërmjet PZAP-it dhe Gjykatës Supreme për të siguruar qasje të njëtrajtshme dhe koherente në drejtësinë zgjedhore. Këshilli Gjyqësor, përmes trajnimeve të përbashkëta dhe analizave krahasuese të praktikës gjyqësore, duhet të kontribuojë në ndërtimin e një jurisprudence të qëndrueshme dhe të parashikueshme, që respekton të drejtën për ankesë, por gjithashtu mbron integritetin e procesit zgjedhor.

- 6

Të formalizohet mekanizmi për referimin e rasteve penale në Prokurori nga ana e institucioneve zgjedhore. PZAP dhe KQZ duhet të kenë një protokoll të qartë bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit për raportimin e rasteve që përmbajnë elemente të veprave penale. Ky protokoll duhet të përfshijë kriteret për identifikimin e dyshimeve, formatin e referimit dhe afatet për veprim institucional.
- 7

Institucionet e drejtësisë duhet të trajtojnë me prioritet rastet që lidhen me cenimin e fshehtësisë së votës, fotografimin e fletëvotimit, presionin ndaj votuesve, keqpërdorimin e votimit me asistencë dhe dyshimet për organizim të votimit jashtë rregullave. Edhe kur këto raste nuk ndikojnë në rezultatin e përgjithshëm, trajtimi i tyre është i rëndësishëm për besimin publik në proces.

V. Përfaqësimi gjinor

- 1

Të miratohen ndryshime ligjore që e shndërrojnë kuotën 30% për gratë në listat zgjedhore në një objektiv progresiv me targete vjetore që çojnë drejt përfaqësimit të barabartë (50/50), në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. Ky ndryshim duhet të shoqërohet me dispozita që ndalojnë listat me përfaqësim minimal të përsëritur dhe që nxisin rotacionin gjinor në pozitat e larta në lista.
- 2


Të zbatohet Ligji për Barazi Gjinore në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, përfshirë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisionet Komunale Zgjedhore dhe Këshillat e Vendvotimeve. Ky zbatim duhet të përfshijë detyrimin për përfaqësim të balancuar gjinor në përbërje dhe udhëheqje, me raporte vjetore të monitorimit.
- 3

Subjektet politike duhet të sigurojnë mbështetje të barabartë dhe transparente për gratë kandidate gjatë fushatës. Kjo përfshin qasje në financim, hapësirë mediatike, aktivitete publike, materiale promovuese, ekipe fushate dhe paraqitje në debate, në mënyrë që gratë kandidate të kenë mundësi reale për garë të barabartë brenda listës.


Shtojca 1: Rezultatet e certifikuara te zgjedhjeve dhe ndarja e ulëseve sipas subjekteve politike

Subjekti politik	Votat	Përqindja	Ulëse
Lëvizja VETËVENDOSJE!	382,869	47.13%	53
Partia Demokratike e Kosovës – PDK	157,892	19.44%	22
Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK	135,567	16.69%	18
Srpska Lista	43,843	5.40%	9
AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës	54,729	6.74%	7
Kosova Demokratik Türk Partisi – KDTP	5,709	0.70%	2
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	5,447	0.67%	1
Koalicija Vakati	3,910	0.48%	1
Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës – IRDK	3,492	0.43%	1
Nova Demokratska Stranka	2,693	0.33%	1
Socijaldemokratska Unija – SDU	2,682	0.33%	1
PSA	2,598	0.32%	1
Partia Liberale Egjiptiane	2,199	0.27%	1
Jedinstvena Goranska Partija	1,650	0.20%	1
Partia Rome e Bashkuar e Kosovës – PREBK	905	0.11%	1
Gjithsej			120

Shtojcat 2 dhe 3: Përfaqësimi i grave sipas subjekteve politike



Subjekti politik	Ulëse gjithsej	Gra të zgjedhura	Burra të zgjedhur	Gra me vota preferenciale	Gra përmes kuotës
Lëvizja VETËVENDOSJE!	53	19	34	19	0
PDK	22	7	15	5	2
LDK	18	6	12	6	0
AAK	7	3	4	0	3
Srpska Lista	9	3	6	2	1
KDTP	2	1	1	1	0
Za Slobodu Pravdu i Opstanak	1	0	1	0	0
Koalicija Vakrat	1	0	1	0	0
IRDK	1	0	1	0	0
Nova Demokratska Stranka	1	1	0	1	0
SDU	1	1	0	1	0
PSA	1	0	1	0	0
Partia Liberale Egjiptiane	1	0	1	0	0
Jedinstvena Goranska Partija	1	0	1	0	0
PREBK	1	0	1	0	0
Gjithsej	120	41	79	35	6



Përkrahur nga:

